

Arlinda Sukaliqi Ali Gjeçbritaj Rrok Gjolaj

E DUA SHKOLLËN

LETËRSIA 1

Për klasën e parë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2021

Arlinda Sukaliqi Ali Gjeçbritaj Rrok Gjolaj

E DUA SHKOLLËN

LETËRSIA 1

PËR KLASËN E PARË TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT

VOLIM ŠKOLU

KNJIŽEVNOST 1

ZA PRVI RAZRED OSNOVNE ŠKOLE

PRIRUČNIK ZA NASTAVNIKE

Botuesi: *Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë*

Për botuesin: *Pavle Goranoviq*

Kryeredaktor: *Radulle Novoviq*

Redaktor përgjegjës: *Llazo Lekoviq*

Redaktor i librit: *Dimitrov Popoviq*

Recensues: *Dr. Marko Camaj*
Mr. Marjan Lulgjuraj
Mr. Leze Cacaj
Fran Vulaj
Mr. Ardita Kovaçi

Ilustrimet: *Marija Popoviq*

Dizajni dhe faqosja: *Nikolla Knezhevqi*

Redaktore teknike: *Dajana Vukçeviq*

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2390-4
COBISS.CG-ID 18856196

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin 19-05-119/21-6405/9 të datës 29.07.2021 e ka miratuar këtë Libër të mësuesit për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mesimore, Podgoricë, 2021

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
LUAJMË SË BASHKU	8
Mësimi 1. HAPADOLLAPA – <i>Popullore</i>	9
Mësimi 2. ÇFARË THONË KAFSHËT – <i>Mehmet Alihoxha</i>	10
Mësimi 3. HYJO KALO – <i>Nexhati Tafa</i>	11
Mësimi 4. VJESHTA	12
MREKULLITË E NATYRËS	13
Mësimi 5. LUMI	14
Mësimi 6. QUKAPIK, O QUKAPIK – <i>Adelina Mamaqi</i>	15
Mësimi 7. DIELLI DHE REJA – <i>Xhahit Bushati</i>	16
Mësimi 8. O, YLBER I BUKUR – <i>Xhevat Beqaraj</i>	17
ORKESTRA E KAFSHËVE	18
Mësimi 9. BLETA	19
Mësimi 10. VJERSHA E KALTËR – <i>Hajro Ulqinaku</i>	20
Mësimi 11. DERRKUCI KAPET ROB – <i>Gaqo Bushaka</i>	21
Mësimi 12. MIQTË E PYLLIT – <i>Gordon Volke dhe Dudly Mosoleu</i>	22
FOLEZA IME E ARTË	23
Mësimi 13. KAÇUBA E IRIQIT – <i>Xhahid Bushati</i>	24
Mësimi 14. NINANANA – <i>Ninullë</i>	25
Mësimi 15. EDUKATA – <i>Dritëro Agolli</i>	26
Mësimi 16. FAMILJA – <i>Tasim Gjokutaj</i>	27
Mësimi 17. SJELLJA E MIRË – <i>Këngë për fëmijë</i>	28
GJERDANI I PËRRALLAVE	29
Mësimi 18. KËSULËKUQJA – <i>Vëllezërit Grim</i>	30
Mësimi 19. PRINCESHA ME BIZELE – <i>Hans K. Andersen</i>	31
Mësimi 20. BORËBARDHA – <i>Hans K. Andersen</i>	32
Mësimi 21. MIU DHE ELEFANTI – <i>Fabul</i>	33
MAGJIA E FESTAVE	34
Mësimi 22. VITI I RI	35
Mësimi 23. DITË DIMRI	36
Mësimi 24. FESTA JOTE, FESTA IME – <i>Adelina Mamaqi</i>	37
Mësimi 25. NJË QERSHORI	38
Mësimi 26. E DUA SHKOLLËN SA BUKUR KËTU!	39
TEKSTE JOLETRARE, LETRARE E TË TJERA	41

PARATHËNIE

Të nderuar kolegë!

Ky libër që mbani në duar është kompleti i ri i Tekstit mësimor për lëndën e Letërsisë, konkretisht (Librin e nxënësit dhe librin e mësuesit) për klasën e parë të shkollës fillore. Ky komplet i ri do të ketë risi, sepse në të janë përfshirë tema të reja, qofshin ato vjersha, tregime, përralla ose fabula të cilat gjithsesi janë hartuar sipas reformës arsimore që zbatohet në Mal të Zi.

Libri i ri i nxënësit, përveç përfshirjes së temave të reja, të cilat nuk ishin në librin e mëparshëm u mundëson nxënësve që të zbulojnë me intuitë disa dukuri gjuhësore, të cilat bëjnë të mundur mësimin e gjuhës shqipe saktë, bukur e pa gabime.

Ai mban parasysh botën e fëmijës si: lojërat, kafshët, ëndrrat, edukimin me dashuri për prindërit, festat, shkollën etj. Ai u ofron mundësinë për të dëgjuar, folur, lexuar siç kërkojnë standardet e metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies.

Kur është bërë përzgjedhja e temave që do ketë ky libër, ne kemi qenë të vetëdijshëm se pasuria e vlerat e rëndësishme letraro-artistike janë të mëdha në letërsinë bashkëkohore për fëmijë, e jemi munduar që të përzgjedhim ato tekste që do të zgjojnë më shumë interesimin e nxënësit dhe përmes së cilave ai do udhëtojë në botën e fantazisë fëmijërore. Në këtë tekst janë bashkuar përmbajtje të llojllojshme të domosdoshme për zhvillimin intelektual të një fëmije gjashtë vjeçar, duke mbajtur parasysh të gjithë larminë e intelektit të fëmijëve.

Tekstet letrare nuk janë të lehta të shpjegohen, sidomos për një moshë të vogël siç janë gjashtëvjeçarët e klasës së parë, prandaj varet nga ne se si do i nxisim ata që të dëgjojnë me vëmendje këto tekste dhe në këtë mënyrë bota e tyre do të pasurohet me fantazi të reja....

Ata me padurim presin të dëgjojnë diçka të re kur vijnë në shkollë, sepse shkollën e shohin si burim të ri të informimit, prandaj le të jemi ne ata që u hapim dyert e reja në mendjen e tyre dhe të jenë ata iniciatorët që nesër të flasin për atë çka kanë mësuar nga ne gjatë leximit, tregimit ose rrëfimit të vjershave, përrallave etj.

Le të jenë përmbajtjet e vjershave, përrallave, fabulave ato që do nxisin dashurinë për librin, e kjo gjithsesi arrihet, nëse ne u ofrojmë libra me vlerë, tekste letrare të bukura e interesante.

Se libri është shoku më i mirë i jetës, ne e dimë, por këtë gjë duhet ta bëjmë me dije dhe nxënësve të klasës së parë, të cilët po hasen me këtë "shok të vyeshëm" i cili do t'i shoqërojë gjatë gjithë jetës dhe do të jetë udhërrëfyti më i mirë i tyre për në rrugën e gjatë të dijes.

Është detyrë e jona dhe e prindërve që të mbillet me kohë dashuria ndaj librit, shkollës, prandaj qëndrimi i të rriturve, prindërve e mësuesve është kyç në këtë rast, sepse ato ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e fëmijëve.

Ky tekst mësimor është mbështetur në përvojat më të mira botërore dhe në programin e ri mësimor për klasën e parë, ku mbizotërojnë kërkesat e tipit: vizato, ngjyros, lidh, etj.

Ky libër rekomandon për përdorim edhe shumë mjete didaktike audio-vizuale të ndryshme, të cilat mund të përdoren në kushtet e klasave të shkollave në Mal të Zi.

Libri i nxënësit është i shoqëruar me librin e mësuesit, ku mësuesit do të gjejnë shumë parime, zbërthime didaktike dhe modele mësimi, të cilat pasurojnë përvojat vetjake të mësuesve.

Po ashtu ky tekst përmban tekste letrare të cilat mësuesi/ja i lexon në mënyrë shprehëse në orën e mësimi, ose prindi në shtëpi. Ajo që e bën të veçantë këtë libër është se çdo tekst shoqërohet me ilustrime, të cilat bëjnë të mundur që ai ta kuptojë përmes ilustrimeve atë çka përmban vjersha, tregimi, fabula, përralla pa e lexuar fare atë.

Titullin e tekstit jemi munduar ta përzgjedhim me kujdes, për vetë faktin se ai ndikon shumë tek nxënësit. Titulli "E dua shkollën" menduam se është më i përshtatshëm, sepse duke

lexuar titullin ata do ta shohin shkollën jo vetëm si një objekt që duhet dëgjuar me vëmendje, ku nuk duhet bërë zhurmë, por si një objekt ku do fitojnë dituri, shkathtësi, do të luajnë të, këndojnë, e në këtë mënyrë inkurajojnë nxënësin ta dojë shkollën dhe atje të shkojë me kënaqësi.

Duhet theksuar se libri është ndarë në gjashtë kapituj që përmbajnë krijime gjysmëletrare, lojëra popullore, vjersha, qoftë për natyrën, kafshët, po ashtu tekste letrare, përralla qofshin ato autoriale ose jo, fabula, tregime të shkurtra ose vjersha për festat më të dashura për fëmijët.

Kapitulli i shtatë “E dua shkollën” dhe i fundit i këtij teksti, është paraparë si hapësirë ku duhet të shprehet fryma krijuese e nxënësve.

Nxënësit mund të shpikin ndonjë lojë, ta luajnë atë, ta vizatojnë, të krijojnë gojarisht ndonjë vjershë a tregim, ta vizatojnë atë ose ta shkruajnë nëse dinë, po ashtu, pas shikimit të ndonjë filmi vizatimor ta tregojnë atë gojarisht, të shkruajnë titullin ose personazhin e ndonjë filmi vizatimor, të rrëfejnë ndonjë përrallë ose ta vizatojnë atë.

Kujdes i veçantë, në çdo kapitull, u është kushtuar ilustrimeve, qofshin ato në tekstet letrare ose gjysmëletrare, të cilat transmetojnë tek nxënësi mesazhe të ngrohta e të kapshme për moshën e tyre, ndërsa ilustrimet në dyfaqëshe paraqesin një paralajmërim domethënës të asaj që do mësojnë në vazhdim, në kapitullin që pason.

Në fund të librit të mësuesit janë renditur disa tekste jo letrare të kapshme për moshën gjashtëvjeçare, si dhe tekste letrare që kuptohen e shijohen lehtë nga fëmijët e vegjël, ku përmes tyre ata dhe argëtohen. Po ashtu, prozat e shkurtra ose të gjata, përrallat janë forma të përshtatshme për fëmijët e kësaj moshe.

Për të punuar si duhet tekstet letrare të përfshira në librin e mësuesit, janë dhënë udhëzimet për çdo temë, ku shumë me rëndësi është që nxënësi duhet motivuar para se të dëgjojë fabulën, vjershën, përrallën..., e mësuesi t’i lexojë ato qartë ato duke përdorë pauzën, të rilexojë nëse duhet, të japë detyra krijuese.

Duhet theksuar se në fund të librit të mësuesit, janë dhënë edhe disa tekste shtesë ku janë përzgjedhur vjersha, fabula, tregime të shkurtra të cilat sipas mendimit tonë do jenë të vlefshme për realizimin e punës suaj në përgjithësi.

Shpresojmë shumë thellë në vetvete se e gjithë kjo që thamë në këtë parathënie dhe gjithçka që kemi përfshirë në Tekstin mësimor, do t’u shërbejë sadopak në punën tuaj të palodhshme, duke ua lehtësuar atë e duke u pasuruar me shumë ide për punën shtesë.

Kurse për nxënësit, shpresojmë që detyrat e dhëna këtu, t’u mundësojnë të përparojnë më një ritëm të vetin, t’i nxisin të vështrojnë dhe të kërkojnë zgjidhje të ndryshme, të kultivojnë kreativitetin dhe të krijojnë bazë për radhitjen e domosdoshme të përmbajtjeve të ndryshme në këtë libër.

Ky tekst me siguri nuk është i hartuar në mënyrë të përsosur dhe gabimet janë të pashmangshme nga ana jonë. Besojmë që të gjejmë mirëkuptimin tuaj, kolegë të nderuar dhe gjithsesi presim rekomandimet e vërejtjet tuaja në botimet e mëvonshme, në mënyrë që ky tekst të arrijë përsosmërinë e duhur.

Autorët

ECURIA METODIKE PËR REALIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR

“LUAJMË SË BASHKU”

Propozime për punën në dyfaqëshen

Mosha parashkollore ose thënë ndryshe 5-6 vjeçare është e mbushur plot me lojëra gazmore dhe zbavitëse. Këto lojëra do të pasqyrohen në dy faqet e para, pra në ilustrimet në **faqen 4 dhe 5 të Tekstit mësimor**, në mënyrë që ai të përdoret si një pjesë hyrëse për një bisedë të ngrohtë, interesante e mbi të gjitha nxënësi të hyjë në botën përrallore të lojërave dhe aty të përdorë fantazinë fëmijërore.

Mund të përdorim metoda të ndryshme të mësimdhënies bashkëkohore: duke formuar punë në grupe, në çifte, lojëra me role, ku nxënësit do të përshkruajnë ndonjë lojë, do ta demonstrojnë vetë ose do ta luajnë në role, e mbi të gjitha do të shprehin ndjenjën e kënaqësisë që do të përjetojnë gjatë mësimit të këtyre vjershave e lojërave të reja.

Veprimtaritë mund të vazhdojnë me nxitjen e fëmijëve për të thënë fjalë të shpejta të ndonjë loje, qoftë ajo popullore që ato dinë, tashmë përmendsh, që njëkohësisht të krijojnë një atmosferë gazmore, që është interesante dhe nxit kureshtjen e nxënësit se çfarë do të ndodhë në fund. Pra është një nxitje emocionale e intelektuale dhe hyrje në veprimtari me punimin e teksteve letrare të këtij kapitulli.

HAPA DOLLAPA

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njihet me vjersha humoristike (zbavitëse) dhe t'i dallojë ato në bazë të leximit nga ana e mësuesit;
- të përjetojë melodinë e vjershës gjatë dëgjimit të leximit;
- të zhvillojë aftësinë për asocim.

Mjetet mësimore të nevojshme: teksti mësimor, fotografi me lojëra humoristike (zbavitëse), lapsa me ngjyra.

Veprimtaritë e MESUES-IT/ES:

- zhvillon një bisedë të lirë me nxënësit për lojërat e tyre më të dashura dhe lojërat që ato luajnë më shpesh në shtëpi, shkollë, kopsht, rrugë, etj. I fton ata të thonë mendimet e tyre që tregojnë se cila është loja e tyre e preferuar, duke pyetur: Si quhet kjo lojë? Pse u pëlqen kjo lojë? Pse pikërisht zgjodhët këtë lojë? Si luhet kjo lojë?;
- kërkon nga nxënësi të thonë gojarisht, nëse dinë ndonjë këngë të ngjashme me fjalë të shpejta.
- diskuton me nxënësit ilustrimet në figurën në **faqen 6 të Tekstit mësimor** duke bërë pyetjet: Kë shihni në figurë? Çfarë po bëjnë fëmijët? A dini si quhet loja që po luajnë fëmijët?
- lexon qartë e në mënyrë shprehëse vjershën "Hapadollapa" në **faqen 6 të Tekstit mësimor**;
- kërkon nga nxënësit të përsërisin disa herë tekstin e kësaj vjershe, në kor, grupe dhe individualisht që ta kenë më të lehtë për ta mësuar përmendsh.
- shpjegon rregullat që duhet të zbatohen nëse duan të mësojnë ta luajnë këtë lojë;
- demonstroi me symbyllur lojën e hapadollapës, gjatë së cilës thuhet edhe teksti i hapadollapës;
- kërkon nga nxënësit t'u përgjigjen gojarisht pyetjeve të detyrës **nr. 1 në faqen 6 të Tekstit mësimor**;
- u ndihmon nxënësve duke u dhënë udhëzime për kryerjen e detyrës **nr. 2 të Tekstit mësimor**;
- ndan nxënësit në grupe dhe organizon lojën, sikurse ajo që luajnë fëmijët e paraqitur në Tekstin mësimor, ose një lojë tjetër, duke kërkuar nga ata që ta luajnë në oborr të shkollës ose në klasë dhe u kërkon që të krijojnë situata të gëzuara në klasë ose në oborr, në mënyrë që atmosfera të jetë sa më gazmore, ku me këtë zhvillohet dhe detyra **nr. 3 në faqen 6 të Tekstit mësimor**;
- kërkon mendimet e nxënësve ose përshtypjet e veta për lojën pa asnjë korrigjim nga ana e mësuesit;
- dëgjon më vëmendje përgjigjet dhe idetë e tyre, i falënderon për pjesëmarrje, i inkurajon e i lavdëron ata;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

MËSIMI 2

Mehmet Alihoxha

ÇFARË THONË KAFSHËT?

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë aftësinë dhe dëshirën për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të dëgjojë e përjetojë tekste të shkurtra letrare artistike të përshtatura me moshën e tij;
- të zhvillojë aftësinë për asocim gjatë dëgjimit (leximit të vjershës);
- të njohë zëra të ndryshëm të kafshëve përmes dëgjimit nga CD ose imitimit nga ana e shokut/qes.

Mjetet mësimore të nevojshme: magnetofoni ose radio me CD me incizimin e zërave të kafshëve; figura (fotografi) të gjelit, maces, qengjit dhe zogut, kartonë të vegjël me foto të kafshëve që janë dhënë në ilustrimet e tekstit mësimor.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES

- bën një bisedë të lirë me nxënësit se a kanë ndonjë kafshë shtëpiake në shtëpi dhe cilat janë ato.
- fton fëmijët, të dëgjojnë incizimin nga CD në radio ose magnetofon me zërat e kafshëve;
- hap librin **në faqen 8 të Tekstit mësimor** dhe diskuton me nxënësit për ilustrimet e paraqitura, duke kërkuar nga ata t'i emërtojnë një nga një kafshët e paraqitura;
- lexon në mënyrë shprehëse vjershën "Çfarë thonë kafshët" në **faqen 7 të Tekstit mësimor**;
- bisedon për përmbajtjen e tekstit të vjershës duke pyetur: Ç'thotë gjeli? Çfarë tha macja Lecin? Po qengji fëmijëve? Cila është porosia e zogut për fëmijët?;
- ndan në katër grupe nxënësit sipas kafshëve në figura për të imituar zërin e tyre;
- grupi i parë - gjelin, i dyti - macen, i treti - qengjin dhe i katërti - zogun; (grupet mund t'i ndërrojnë rolet);
- kërkohet nga nxënësit të imitojnë zërat e kafshëve, varësisht nga grupi që i takon, e nëse ka dëshirë mund të imitojnë ndonjë zë të kafshëve që nuk janë në ilustrim;
- u thotë nxënësve që ta përsëritin vjershën sipas grupeve, për ta mësuar përmendsh nga dy vargje për çdonjërin kafshë;
- fton më të mirët e çdo grupi, që të dalin e të recitojnë para klasës nga një pjesë;
- u thotë nxënësve, që të japin përgjigjet e tyre për detyrën **nr.1 në faqen 7 të Tekstit mësimor**, pastaj, të përfundojnë detyrën **nr.2 (nëse dinë) në fq. 8 të Tekstit mësimor**;
- shkruan në tabelë ose në kartonë, me shkronja të mëdha emërtimet e kafshëve e të zogjve.
- u thotë nxënësve, të zhvillojnë (nëse dinë) detyrën **nr.3 në faqen 8 të Tekstit mësimor**.

Vërejtje e mësuesit-it/es

MËSIMI 3

Nexhati Tafa

HYJO KALO

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të përketojë melodinë e vjershës;
- t'i dallojë dhe t'i kuptojë vjershat gazmore;
- të njohë dhe të dallojë fjalë të reja siç është fjala "jele";

Mjetet mësimore të nevojshme: fotografi me figurën e kalit, teksti mësimor, mjetet e vizatimit.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- u tregon fëmijëve figurën ose fotografinë e kalit dhe bisedon për këtë kafshë;
- lexon vjershën "Hyjo, kalo" **në faqen 9 të Tekstit mësimor**, titulli i së cilës mund të shkruhet me shkronja të mëdha shtypi dhe të varet në tabelë pranë figurës ose fotografisë së kalit;
- bëhet rileximi disa herë i vjershës në mënyrë të qartë dhe shprehëse për t'u mësuar më lehtë përmendsh;
- zhvillon një bisedë të lirë me nxënësit duke bërë pyetje të tipit: Për kë flitet në vjershë? A ka ndonjë fjalë që nuk e kuptoni në vjershë? Si i ka jelet kali?
- bisedon me nxënësit për ilustrimin në figurën **në faqen 9 të Tekstit mësimor**;
- fton fëmijët të zhvillojnë detyrën **nr.1 në faqen 10 të Tekstit mësimor**, duke u lexuar mësuesi pyetjen, e ato të ngjyrosin katrorin pranë përgjigjes së saktë.
- u thotë nxënësve të zhvillojnë detyrën **nr.2 në faqen 10 të Tekstit mësimor**;
- u jep udhëzime për kryerjen e detyrave të dhëna;

Vërejtjet e mësuesit-it/es:

.....

VJESHTA

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të dallojë dhe të përjetojë melodinë e vjershës gjatë leximit shprehës;
- të zhvillojë aftësinë për asocim gjatë dëgjimit të leximit të vjershës;
- të kuptojë dhe përdor drejt fjalën titull (koncept);
- të njohë dhe të përdorë fjalë dhe shprehje të reja;

Mjetet mësimore të nevojshme: pamja e vjeshtës (fotografi të ndryshme me vogëlushë të cilët mbajnë fruta në duar, druri i mollës, dardhës me fruta në të, vreshti etj.); fleta formati A4 me fruta të vizatuara të pangjyrosura, lapsa me ngjyra, tempera, magnetofoni me CD...

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- lëshon sipas dëshirës një incizim muzikor me motive vjeshte në sfond;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimin në **faqen 11 të Tekstit mësimor** dhe të tregojnë se çfarë shohin në të;
- lexon vjershën “Vjeshta” në **faqen 11 të Tekstit mësimor** duke u ndalur posaçërisht në shpjegimin e titullit të saj;
- bën një pushim të shkurtër për të parë mbresat e nxënësve;
- rilexon vjershën dhe bisedon duke pyetur: Për çfarë bëhet fjalë në këtë vjershë? Kush e pyet vjeshtën për dhuratat? Pse e pyet? Pse qesh dhe a qesh dot vjeshta? Cilat janë dhuratat e vjeshtës?;
- sqaron dhe shpjegon fjalët dhe shprehjet më pak të njohura ose të panjohura si bie fjala: vjeshtë e artë, dhuratë, fryt etj.;
- i pyet nxënësit se a janë të shëndetshme frutat? Cilat fruta ju pëlqejnë më shumë?
- u thotë nxënësve të vizatojnë frutat që piqen në vjeshtë (**detyra 3 në faqen 11 të Tekstit mësimor**);
- kontrollon punën, udhëzon dhe ndihmon, nëse është e nevojshme pa ndikuar në shprehjen e lirë figurative të fëmijëve;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

MREKULLITË E NATYRËS

Propozime për punën në dy faqëshen

Natyra dhe fëmijët janë miqtë më të mirë me njëri-tjetrin, duke marrë parasysh këtë fakt vjershat, përrallëzat, që janë përfshirë në këtë kapitull janë të lidhura ngushtë me dukuritë e natyrës, me bukuritë e rralla të saj, të cilat fëmijët i vëzhgojnë dhe e kuptojnë si merren vesh qeniet e gjalla për rreth tyre.

Në ilustrimin e paraqitur në **fq. 12, 13 të Tekstit mësimor**, vendin kryesor e zënë fëmijët dhe miqtë e tyre, kafshët.

Duke vëzhguar këto ilustrime, detyrë e nxënësve është t'i njohin kafshët, të imitojnë ndonjë nga kafshët në figura, t'i improvizojnë ato në klasë.

Ja cilat mund të jenë disa nga veprimtaritë që mund të kryhen në orën mësimore:

1. vëzhgim i figurave dhe shkëmbim i mendimeve ose ideve lidhur me atë vëzhgim;
2. ndarja e nxënësve në grupe përkatëse duke u dhënë detyrat e caktuara;
3. sqaron detyrat e dhëna dhe ndihmon në zgjidhjen e tyre;
4. demonstrimi i detyrave të dhëna;
5. diskutim mbi rezultatet e fituara;
6. inkurajim dhe lëvdata për punën e kryer, duke u bërë me dije se falë natyrës që buzëqesh sot, klasa jonë buzëqeshi dhe krijoi një atmosferë të gëzuar në klasë.

LUMI

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të njohë dhe të përjetojë melodinë e vjershës;
- të kuptojë realitetin e paraqitur ose të pasqyruar në tekste letrare dhe të aftësohet që ta paraqesë atë në ndonjë formë tjetër;
- të nxitet dëshira për të formuar vetë tekste të tilla letrare lidhur me bukuritë e natyrës;

Mjetet mësimore të nevojshme: pamje, fotografi ose piktura ku paraqitet lumi, mjetet e vizatimit.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- nis orën duke hapur tekstin mësimor në **faqen 14 të Tekstit mësimor**, fton fëmijët të shikojnë ilustrimin, ku paraqitet lumi.
- bisedon për ilustrimin duke pyetur: Ku lahemi ne në verë? A keni parë ndonjëherë lumë? A ka ndonjë lumë në qytetin tënd ose në fshatin ku jeton ti? Si quhet ai lumë? etj;
- dëgjon me vëmendje përgjigjet e dhëna nga nxënësit;
- lexon në mënyrë shprehëse vjershën "Lumi" në **faqen 14 të Tekstit mësimor**;
- kërkon nga fëmijët t'u përgjigjen pyetjeve të detyrës **nr.1 dhe nr.2 në fq.14 të Tekstit mësimor**;
- kërkon nga nxënësit të shikojnë ilustrimin dhe të komentojnë me fjalët e veta ilustrimin;
- organizon interpretimin në dialog të vjershës (mësuesi thotë vargun e parë e të tretë, ndërsa nxënësit vargun e dytë dhe të katërt);
- duke rilexuar disa herë vjershën fton nxënësit të mësojnë ndonjë varg përmendsh;
- udhëzon nxënësit për zhvillimin e detyrës **nr.3 në fq.14 të Tekstit mësimor** dhe u thotë, të shkruajnë, nëse dinë emrin e vet poshtë vizatimit.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

.....

MËSIMI 6

Adelina Mamaqi

QUKAPIK, O QUKAPIK

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë ndjenjën ose dëshirën për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të shprehë ndjenjat e veta pas dëgjimit të vjershës;
- të dallojë fjalët që përsëriten në vjershë;
- të përgjigjet me gojë në pyetjet e dhëna në vjershë;

Mjetet mësimore të nevojshme: letra në formë A4, lapsat me ngjyra ose bojërat tempera, radio, CD me incizime të çukitjes së qukapikut etj.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- nis mësimin me dëgjimin e incizimit të cicërimës e të këngës së zogjve dhe të krismës së çukitjes të qukapikut në trungun e drurit;
- u thotë nxënësve që, nga gjithë zërat e zogjve, që kanë dëgjuar në incizim, të kristalizojnë e të mbajnë mend krismën e çukitjes së qukapikut;
- lexon vjershën "Qukapiku" në mënyrë shprehëse në **faqen 16 të Tekstit mësimor**;
- kërkon nga nxënësit të shikojnë ilustrimin në **faqen 16** dhe ta komentojnë atë;
- rilexon vjershën disa herë duke i pyetur nxënësit: A keni parë ju ndonjëherë qukapik? Përshkruani atë.
- u thotë nxënësve të zgjidhin **detyrën nr.1** me vizatim dhe **detyrën 2** me ngjyrosje në **faqen 17 të Tekstit mësimor**;
- shikon dhe ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme;
- inkurajon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

.....

MËSIMI 7

Xhahid Bushati

DIELLI DHE REJA

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë përrallën në bazë të formës dhe disa tipareve të saj;
- të ritregojë përmbajtjen e përrallës;
- të shprehë ndjenjat e veta pas dëgjimit të leximit të përrallës;
- të përgjigjet me gojë në pyetjet rreth tekstit të lexuar;

Mjetet mësimore të nevojshme: fotografi ose ilustrime të diellit dhe resë, mjetet e nevojshme për vizatim dhe ngjyrosje si ngjyrat e lapsit ose temperat, teksti mësimor.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- nis orën me një bisedë rreth motit ku nxënësve u drejtohet me këto pyetje: Çfarë moti është sot? Po dje si ishte moti? Çfarë moti dëshironi më shumë? Me shi apo me re? Me diell? Me borë?
- demonstroi fotografi ose ilustrime me figurën e Diellit dhe resë;
- diskuton rreth tyre se çfarë dinë ata rreth reve dhe Diellit, dëgjon mendimet e tyre pa asnjë korrigjim;
- i fton nxënësit të shikojnë ilustrimin në faqen 18 të Tekstit mësimor, duke u thënë të vërejnë ilustrimin në të dhe të tregojnë se si duket Dielli dhe reja në ilustrim, pra të komentojnë ato ashtu siç ua merr mendja;
- mësuesi/ja lexon përrallën ngadalë dhe rrjedhshëm;
- kërkon nga nxënësit që të zgjidhin detyrën nr.1 dhe 2 në faqen 19 të Tekstit mësimor, duke i udhëzuar e nëse duhet, edhe t'i ndihmojë;
- u thotë nxënësve të zgjidhin detyrën nr.4 me ngjyrosje në faqen 19 të Tekstit mësimor;
- vlerëson pozitivisht punimet e nxënësve.

Vërejtje mësuesit-it/es

MËSIMI 8

Xhevat Beqaraj

O YLBER I BUKUR

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vrojtojë realitetin e pasqyruar në vjershë dhe ta komentojë atë nga këndvështrimi vetjak;
- të njohë dhe të përjetojë melodinë e vjershës;
- të nxitet dhe të mbajë mend përvojën vetjake estetiko-letrare dhe mbi bazën e saj të formulohen dëshirat;
- të thotë argumentet përse u ka pëlqyer kjo vjershë.

Mjetet mësimore të nevojshme: mjetet për vizatim dhe ngjyrosje, shiriti shumëngjyrësh, teksti mësimor, fotografi (ilustrime) me figurën e ylberit.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- nis mësimin duke demonstruar fotografi dhe vizatime me figurën e ylberit. I pyet nxënësit se si quhet ai që është në figurë? Kur shfaqet ai? Sa ngjyra ka? Shkruan në tabelë ose mbi vizatime me shkronja të mëdha emrin YLBERI.
- u thotë të shikojnë ilustrimet **në faqen 20 të Tekstit mësimor** dhe i komentojnë ato;
- shiritin shumëngjyrësh që ka përgatitur mësuesi/ja, ua jep nxënësve ta mbajnë në skaje, i cili përfaqëson gjoja ylberin dhe zhvillon një lojë, duke i ndarë në grupe fëmijët dhe duke u thënë ta kapërcejnë atë, thua se është një ylber i vërtetë;
- lexon në mënyrë shprehëse (ekspresive) vjershën "O, ylber i bukur" **në faqen 20 të Tekstit mësimor**;
- i pyet ata, nëse kanë ndonjë gjë të paqartë dhe u shpjegon përmbajtjen e vjershës;
- kërkon nga nxënësit, ta përshkruajnë me fjalë të veta ylberin;
- kërkon nga nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve të detyrës **1, 2 dhe 3 në faqen 20 të Tekstit mësimor**;
- udhëzon dhe ndihmon nxënësit për zhvillimin e detyrës **në faqen 21 të Tekstit mësimor** dhe u thotë të shkruajnë (nëse dinë) emrin e vet poshtë vizatimit.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

ORKESTRA E KAFSHËVE

Propozime për punën në dyfaqëshen

Kafshët janë ato që zënë vendin më të madh në **ilustrimet e faqeve 22 dhe 23 të Tekstit mësimor**, prandaj më të drejtë dhe ky kapitull është quajtur “ORKESTRA E KAFSHËVE”, duke e ditur se bota shtazore ka një ndikim të madh tek fëmijët dhe dashuria ndaj tyre është më se e natyrshme. Në këtë kapitull nxënësit do të kenë mundësi të shohin mjedise të ndryshme të botës shtazore.

Fillimi i këtij kapitulli parashihet që të jetë një bisedë hyrëse për kafshët që nxënësit i njohin dhe i duan pa masë.

Kafshët e paraqitura në këtë kapitull janë personazhet kryesore e ndonjëherë dhe si dytësore të krijimeve letrare, qofshin ato në prozë ose në poezi (vjersha).

Disa propozime që mund të hyjnë në punë në mënyrë që ecuria e orës të jetë e frytshme janë këto:

1. Vrojtimi me vëmendje i ilustrimeve;
2. Emërtimi i kafshëve që njohin dhe atyre që do të njohin në vazhdim gjatë leximit nga mësuesi/ja të teksteve letrare popullore të përshtatura për moshën e tyre;
3. Këndim i këngëve të ndryshme të njohura për kafshët dhe zhvillimi i ndonjë loje me imitim të zërave të kafshëve
4. Nxitja e nxënësve që të shprehin me fjalë ose vizatim ndjenjat e veta për ndonjë kafshë që pëlqejnë;

Në këtë mënyrë nxënësi do shprehet më lirshëm për ngjarjet nga jeta e përditshme me kafshët që ai/ajo ka në shtëpi dhe inkurajohet që të dalë para klasës pa ndrojtje, t’i tregojë eksperiencat e tij lidhur me kafshët më të dashura;

Ora mund të vazhdohet me shikimin e ndonjë përralle me kafshë në TV, ose të lexohet një përrallë nga ana e mësuesit/ses.

BLETA

Arritjet e të nxëniet:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të kuptojë realitetin e pasqyruar në tekstin letrar dhe ta shohë atë nga këndvështrimi i tij;
- të njohë dhe të përdorë fjalë dhe shprehje të reja;
- të vërejë se çfarë arrin me fjalët dhe shprehjet e reja që ka përdorur;

Mjetet mësimore të nevojshme: figura ose fotografi të bletës, foto ose fotografi të kosheres së bletës, figura ose fotografi të bletëve duke u futur në zgjua, figura ose fotografi të një ene për mjaltë (shishe ose kavanoz) me mjaltë, gërshtë, lapsa me ngjyra, akualet ose tempera etj.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- bisedon me nxënësit për pushimet e tyre në fshat, për lojërat e bukura që kanë luajtur gjatë pushimeve me shokët, për punët e ndryshme në fshat etj;
- organizon bisedën me një bletërritës dhe për profesionin e tyre (bletarinë);
- u thotë nxënësve, të shohin me vëmendje ilustrimin në **faqen 24 të Tekstit mësimor** dhe të vërejnë detajet në të;
- u tregon nxënësve për disa veçori kryesore të bletës;
- lexon në mënyrë shprehëse vjershën “Bleta” në **faqen 24 të Tekstit mësimor**;
- bisedon me nxënësit lidhur me tekstin e lexuar: Përse mbarështojmë bletët? A ju pëlqen mjalti? A është bleta punëtore? A duhet dhe ne të jemi punëtorë si bleta?;
- sqaron dhe u shpjegon nxënësve kuptimin e fjalëve më pak të njohura ose të panjohura si: polen, dyllë, koshere, zgjua etj.;
- u kërkon nxënësve të zhvillojnë **detyrën 1 në faqen 24 të Tekstit mësimor**, ku në ilustrimin e paraqitur kërkohet të rrumbullakohen kudo ku shohin bletë;
- u kërkon nxënësve të realizojnë **detyrën 2 dhe 3 në faqen 24 të Tekstit mësimor**;
- kontrollon punën e nxënësve dhe u ndihmon aty ku kanë nevojë;
- ekspozon punimet e nxënësve në stendën e klasës të bërë enkas për këtë;
- i nxit nxënësit të vlerësojnë punimet e veta të përbashkëta;
- lavdëron punën e çdo nxënësi veçmas;

Vërejtjet e mësuesit-it /es

MËSIMI 10

Hajro Ulqinaku

VJERSHA E KALTËR

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë me vëmendje vjershën e lexuar nga mësimdhënësi;
- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të krijuar qoftë me vizatim ose me të shprehur me fjalët veta tekste letrare artistike me të njëjtën temë;
- që realitetin e paraqitur në tekstin letrar e trajton nga këndvështrimi vetjak;
- të rrëfejë mbi përvojat personale në lidhje me të njëjtën temë;
- të dallojë dhe të përfytyrojë melodinë e vjershës;
- të kuptojë dhe të përdorë drejt fjalët (konceptet) poet dhe titull.

Mjetet mësimore të nevojshme: fletët e vizatimit format A4 me peshq të vizatuara, por të pangjyrosur; lapsat me ngjyra ose temperat (akualet), mjetet e tjera ndihmëse të vizatimit.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- fillon orën me një bisedë të lirë duke i pyetur nxënësit se ku lahen ata gjatë verës? A luajnë ndonjë lojë pranë lumit, detit, liqenit?
- nëse ato tregojnë ndonjë lojë, mësuesi organizon në klasë atë lojë që pëlqehet nga fëmijët dhe që luhet në breg të detit;
- fton nxënësit të shikojnë me vëmendje ilustrimin në **faqen 25 të Tekstit mësimor** dhe të diskutojnë për të;
- lexon në mënyrë ekspresive vjershën "Vjersha e kaltër" në **faqen 25 të Tekstit mësimor**;
- shpjegon me konkretizim kuptimin e fjalëve (koncepteve) poet dhe titull;
- pasi rilexon vjershën përsëri bën pyetje të tipit: A ju pëlqen ju stina e verës? Po në vjershë çfarë ngjyre ka vera? Po deti çfarë ngjyre ka? Ç'ngjyrë ka qielli? Kush noton në det? Çfarë ngjyre kanë peshqit? Kush i zë peshqit?
- shpjegon kuptimin e fjalëve më pak të njohura për nxënësit,
- fton nxënësit të zhvillojnë **detyrën 2 dhe 3 faqen 25 të Tekstit mësimor**;
- organizon punën në grupe: ndan fletët format A4 të vizatuara me peshq, por të pangjyrosura, të cilat nxënësit i ngjyrosin sipas dëshirës dhe fantazisë së tyre të lirë;
- mësuesi ndihmon, nëse është e nevojshme;
- fton fëmijët që punimet e veta t'i paraqesin para klasës;
- në fund të orës, për t'u çlodhur mund të lëshojmë sipas dëshirës, ndonjë incizim muzikor të përshtatshëm ose organizon ndonjë lojë argëtuese me motive nga stina e verës.

Vërejtjet e mësuesit-it /es

Gaqo Bushaka

DERRKUCI KAPET ROB

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të veçojë pjesët që i kanë pëlqyer më shumë nga tregimi;
- të përshkruajë ngjarjen dhe personazhet e tekstit letrar pavarësisht përjetimit personal;
- të shprehë ndjenjat e veta për tregimin e lexuar nga ana e mësimdhënësit;
- që realitetin e tekstit e paraqesin me vizatim.

Mjetet mësimore të nevojshme: ilustrime ose fotografi të kafshëve të paraqitura në tregim si: derrkuci, ariu, lepurushi, mjellma etj, gërshtë, copa kartoni, lapsa me ngjyra apo bojëra tempera (akuael).

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- u tregon nxënësve fotografitë e derrkucit dhe ariut dhe zhvillon bisedë me nxënësit lidhur me ta;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimet në **faqen 26 të Tekstit mësimor** dhe t'i ngjyrosin ato;
- u jep nxënësve disa njohuri themelore për kafshët e përmendura në tekst;
- lexon në mënyrë shprehëse tregimin "Derrkuci kapet rob";
- pyet nxënësit a e dinë çdo të thotë shprehja kapet "rob", e nëse shpjegimet e tyre janë të pamjaftueshme, atëherë shpjegon vetë kuptimin e shprehjes;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimet e pangjyrosura në **faqen 26 dhe 27 në Tekstin mësimor** dhe i fton t'i ngjyrosin pastaj ato;
- fut nxënësit në veprimtarinë e re duke i pyetur: Pse derrkuci Çufo u zu rob? Kush e zuri duke vjedhur molla? Te kush e dorëzoi Çufon, ariu Zebo? Çfarë e porosi mësuese mjellma?;
- nxit nxënësit për bisedë për personazhet e tregimit duke identifikuar nxënësin me personazhin e tregimit;
- pyet nxënësit cili është personazhi që u ka pëlqyer më shumë ose cila pjesë e tregimit u ka pëlqyer më shumë, e nëse e ka mbajtur mend, e ritregon para klasës.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

MIQTË E PYLLIT

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të kuptojë dhe të ritregojë përmbajtjen e përrallës;
- të shprehë ndjenjat e veta pas dëgjimit të leximit të përrallës;
- të krahasojë personazhet e përrallës me vetveten;

Mjetet e nevojshme mësimore: fotografi me ilustrime me insekte e: lavrës, milingonës, mollëkuqes dhe kërpudhës, ngjyra lapsi ose tempera, mjete ndihmëse për vizatim...

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- fton nxënësit të shikojnë ilustrimet e përgatitura nga mësuesi të: kërpudhës, lavrës, milingonës dhe mollëkuqes dhe kërkon nga nxënësit t'i emërtojnë ato nëse dinë;
- kërkon nga nxënësit të thonë çfarë kuptojnë me fjalën "miq" e nëse nxënësit nuk dinë të tregojnë, mësuesi/ja e plotëson atë me shpjegimet e duhura;
- mësuesi lexon pjesën "Miq të e pyllit" në faqen 46 të Librit të mësuesit;
- fton nxënësit të shikojnë ilustrimin në faqen 28 të Tekstit mësimor duke kërkuar nga ata të shohin me vëmendje ilustrimin dhe ta komentojnë atë;
- bën një pauzë të shkurtër për të sistemuar mendimet e mbresat e nxënësve;
- kërkon nga nxënësit të zhvillojnë detyrën nr.1 në faqen 28 të Tekstit mësimor;
- kontrollon dhe ndihmon nxënësit, nëse kanë nevojë;
- mësuesi kërkon që ata të thonë, se si ishin insektet e pyllit që hasen në ilustrim;
- fton nxënësit të kryejnë detyrën nr.2 në faqen 29 të Tekstit mësimor, ku kërkohet nga nxënësit të ngjyrosin kërpudhën, ndihmon, nëse ka nevojë;
- kërkon nga nxënësit të kryejnë detyrën 3, 4 në faqen 29 të Tekstit mësimor;
- në detyrën nr.5 të faqes 29 në Tekstin mësimor, mësuesi kërkon nga nxënësit të formojnë grupe katërshe, të ndajnë rolet dhe të interpretojnë përrallën;
- nxënësit luajnë në role përrallën.

Vërejtjet e mësuesi-it/es

FOLEZA IME E ARTË

Propozime për punën në dyfaqëshën

Shtëpia është vendi më i ngrohtë për të gjithë ne, sidomos për fëmijët e moshës shkollore të cilët ngrohtësinë më të madhe e gjejnë pranë shtëpisë së tyre dhe pranë anëtarëve të familjes. Edhe në ilustrimin në **faqen 30 dhe 31 të Tekstit mësimor** është marrë një pamje ku shihen pjesë të shtëpisë dhe aty paraqiten personazhe të lumtura e të kënaqura në shtëpinë e vet të ngrohtë e të sigurt.

Fillimisht mësuesja mund të kërkojë nga nxënësit ta përshkruajnë shtëpinë që shohin në fotografi, ilustrim ose shtëpinë e tyre.

Propozime për ecurinë e mëtejme të veprimtarive:

1. Secili nxënës mund të vizatojë shtëpinë e vet në fletore, ose në ndonjë fletë të formatit A4
2. Nxënësit nxiten të tregojnë e të flasin lirshëm për shtëpinë e tyre.
3. Nxënësit mund të shohin paraprakisht fotografi nga vjersha "Nina - nana" tek **faqja 34 e Tekstit mësimor**, ilustrimin të vjersha "Familja" në **faqen 38** për të zgjeruar edhe më shumë hapësirën e diskutimit të tyre për rolin e rëndësishëm që kanë shtëpia dhe anëtarët e saj.
4. Mendimet e tyre rreth asaj se çfarë kanë parë dhe kuptuar nga përmbajtjet e temave më lart mund t'i shkruajë mësuesi me shkronja të mëdha dhe të shënohen ato në ndonjë karton të ngjitur në mur, në të cilin është vizatuar një pemë e madhe dhe secila degë e pemës do të ketë një mendim të nxënësit, në mënyrë që ata t'i kenë aty prezent sa herë t'i kthehen këtij kapitulli.

MËSIMI 13

Xhahid Bushati

KAÇUBA E IRIQIT

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë e të dallojë personazhet letrare;
- të shpreh mesazhin e tregimit duke e vizatuar ose thënë me fjalë;
- të dallojë motivet e sjelljes së personazheve të njohura letrare sipas përvojës vetjake;
- të thotë argumentet përse u ka pëlqyer ose jo ky tregim.

Mjetet mësimore të nevojshme: seria e figurave nga teksti mësimor, lapsat me ngjyra ose temperat, mjetet e tjera të vizatimit.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- lëshon ndonjë incizim muzikor të përshtatshëm me atmosferën e qetë në shtëpi;
- fton fëmijët të shohin e të diskutojnë bashkërisht atë që shohin në ilustrimin në **faqen 32 të Tekstit mësimor**;
- fillon të bëjë pyetje rreth figurës së iriqit si: A keni parë iriq ndonjëherë? Ku jeton ai? A ka shtëpi ai?;
- pasi ka marrë përgjigjet e nxënësve, i fton ata duke u bërë pyetje tani për figurat në tekst si: Shtëpia e kujt është kjo? Si ju duket shtëpia e iriqit? Ku është ulur iriqi? Përse i duhet llamba iriqit? Çfarë po mendon iriqi?;
- lexon në mënyrë shprehëse tregimin “Kaçuba e iriqit” në **faqen 51 të Librit të mësuesit**;
- bisedon përsëri për përmbajtjen e tregimit duke i pyetur cilat janë personazhet, a ju ka pëlqyer apo jo tregimi me iriqin?;
- duke bërë një pauzë të vogël, mësuesi pret që nxënësit të reflektojnë mbi pyetjet e bëra dhe pret të tregojnë mbresat e veta;
- kërkon nga nxënësit të zhvillojnë detyrën **nr.1 dhe 2 në faqen 32 të Tekstit mësimor**;
- fton nxënësit që me ndihmën e mësuesit të zhvillojnë **detyrën nr.3 në faqen 33 të Tekstit mësimor**;
- u jep detyrë shtëpie të përfundojnë **detyrën 4 në faqen 35 të Tekstit mësimor**;

Vërejtje e mësuesit-it/es

Ninullë

NINANANA

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të dëgjojë me vëmendje kur lexon mësimdhënësi;
- të dallojë dhe të veçojë fjalët në ninullë;
- të trajtojë realitetin e pasqyruar në tekstin letrar nga këndvështrimi individual.

Mjetet mësimore të nevojshme: rrecka, pe, pulla, kashtë, shkopinj të vegjël etj.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- lëshon një incizim muzikor të ndonjë ninulle të njohur e tërheqëse për fëmijë;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimin në **faqen 34 të Tekstit mësimor** dhe të tregojnë se çfarë shohin në të;
- bisedon me nxënësit duke pyetur: Kë shihni në figurë? Ç'bën nëna? Kush u këndon fëmijëve që t'i zërë gjumi? Me ç'zë këndohen ninullat?
- lexon ninullën "Ninanana" në **faqen 34 të Tekstit mësimor**;
- bisedon me nxënësit për dashurinë e nënës e të fëmijës;
- sqaron dhe shpjegon kuptimin e fjalëve më pak të panjohura si: ninullë, nxihen, rrëke, zë (shiu), zë (gjumi)...
- rilexon disa herë ninullën që nxënësit ta mësojnë përmendsh në mënyrë që pastaj nxënësit ta deklamojnë duke imituar nënën që vë fëmijën në gjumë;
- u thotë nxënësve të zhvillojnë, nëse dinë **detyrën numër 1 dhe 2 në faqen 34 të Tekstit mësimor**;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimin poshtë me titullin brendashkruar "tjerrim, thurim e qëndisim, hajde punës t'ia nisim" në **faqen 34 të Tekstit mësimor** dhe të tregojnë se çfarë shohin në të;
- kërkon nga nxënësit që në shtëpi me ndihmën e prindërve të realizojnë punën për punimin e kukullave me mjetet si në ilustrim dhe kështu zhvillojnë **detyrën nr. 3 të Tekstit mësimor**;
- udhëzon nxënësit për **detyrën nr. 4**, ku u thotë nxënësve të vizatojnë një ëndërr të bukur në **faqen 35 të Tekstit mësimor**;

Vërejtjet e mësues-it/es

MËSIMI 15

Dritëro Agolli

EDUKATA

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të dëgjojë dhe të përjetojë melodinë e vjershës gjatë leximit nga ana e mësimdhënësit;
- të kuptojë tonin humoristik të vjershës;
- të kuptojë realitetin e pasqyruar në vjershë dhe të zhvillojë aftësinë për ta paraqitur atë në mënyra të tjera;
- të kuptojë dhe të përdorë drejt fjalën poet;
- të kuptojë mundësitë e shumta për mirëkuptim në ambientin ku jetojnë;

Mjetet mësimore të nevojshme: lapsat me ngjyra ose bojërat, tempera, fotografi ose ilustrime me kafshët e përmendura në vjershë: macet dhe qentë.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- u thotë nxënësve të shohin ilustrimin në **faqen 36 të Tekstit mësimor** dhe ta përshkruajnë atë me fjalët e tyre;
- mësuesi lexon në mënyrë shprehëse vjershën "Edukata" në **faqen 36 të Tekstit mësimor**;
- u thotë nxënësve të zhvillojnë detyrën 1 në **faqen 37 të Tekstit mësimor** ku kërkohet që nxënësit të ngjyrosin ilustrimin në kornizë;
- bën një pushim të shkurtër dhe rilexon vjershën për t'i sistemuar mbresat;
- bisedon për përmbajtjen e vjershës duke pyetur: Çfarë bënin macet? Çfarë thanë qentë për macet? Çfarë u ra qenve në këmbë? Çfarë bënë qentë me kockën?;
- u thotë nxënësve të vizatojnë në kornizë macen e tyre;
- fton nxënësit të zhvillojnë detyrën **nr. 2 në faqen 37 të Tekstit mësimor**;
- u thotë nxënësve të zhvillojnë **detyrën nr. 3 në faqen 37 të Tekstit mësimor** ku kërkohet të ngjyrosin etiketën pranë përgjigjes së saktë;
- kontrollon punën e fëmijëve dhe u ndihmon, nëse kanë nevojë.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Tasim Gjokutaj

FAMILJA

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- që gjatë leximit të vjershës të dallojë dhe të përfjetojë melodinë e vjershës;
- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të trajtojë realitetin e pasqyruar në tekstin letrar nga këndvështrimi i tij;
- të nxitet që të mbajë mend përvojën vetjake estetiko-letrare dhe mbi bazën e saj të formulojë dëshirat e veta;
- të shprehë me fjalë ose me vizatim ndjenjat e veta për tekstin e lexuar.

Mjetet mësimore të nevojshme: fleta formati A4 me figura të vizatuara të pangjyrosura të anëtarëve të familjes, lapsat me ngjyra ose bojërat tempera (akualet).

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- organizon një lojë që fëmijët e luajnë me kënaqësi në shtëpi;
- u thotë nxënësve të shikojnë me vëmendje ilustrimin në **faqen 38 të Tekstit mësimor** dhe çfarë shohin në të;
- zhvillon bisedën me nxënësin duke pyetur: Kë shihni në figurë? Ç'është familja? Prej kujt përbëhet familja e paraqitur në ilustrim? A ju duket e lumtur kjo familje? Pse është e lumtur? Sa anëtarë ka familja juaj?;
- lexon para nxënësve vjershën "Familja" në **faqen 51 të Librit të mësuesit**;
- bën një pushim të shkurtër për të parë mbresat e nxënësve;
- bisedon me nxënësin për vjershën duke pyetur: Sa anëtarë ka familja juaj? Çfarë punojnë prindërit tuaj? Ku jeton familja juaj? Si e ndihmoni njëri-tjetrin në familjen tuaj? Pse e doni shumë nënën, babanë, gjyshin, gjyshen, vëllain, motrën...? (mësuesi, mësuesja duhet të ketë kujdes në strukturën e klasës që të mos vërë në pozitë të vështirë fëmijët që për arsye të ndryshme nuk kanë familje, nuk e kanë të plotë atë ose jetojnë me prindër të ndarë);
- rilexon përsëri vjershën dhe numëron bashkë me nxënësin pjesëtarët e familjes për të cilët flitet në vjershë;
- udhëzon nxënësin si të punojnë **detyrën numër 1 në faqen 38 të Tekstit mësimor**;
- u shpërndan fletët me figura të vizatuara të pangjyrosura të anëtarëve të familjes të cilat i ngjyrosin sipas dëshirës;
- komenton bashkë me nxënësin domethënien e fjalës në fund të **faqes 38 dhe 39 të Tekstit mësimor**: "Familja është gjëja më e shtrenjtë në botë", "E dua dhe e respektoj familjen time";
- udhëzon nxënësin si ta zhvillojnë **detyrën numër 2 në faqen 39 të Tekstit mësimor**;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

SJELLJA E MIRË

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste artistike letrare;
- të dëgjojë me vëmendje kur lexon mësimdhënësi;
- të dallojë dhe të veçojë fjalët që rimojnë në vjershë;
- të kuptojë drejt mesazhin e vjershës dhe e shpreh atë me fjalë;

Mjetet e nevojshme mësimore: fotografi me situata ku shihen sjellje të mira dhe jot të mira, kartonë me fjalë: TË LUTEM, URDHËRO, FALEMINDERIT etj.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- mësuesi fillon bisedën duke i pyetur ata se si sillen ato në shtëpi, në rrugë dhe në shkollë;
- pyet nxënësit se cilat fjalë përdorin ata kur duan diçka të blejnë në dyqan, ose kur dikush i dhuron diçka...;
- zbulon ilustrimet me situata të shumta të personave në foto ku disa veprime tregojnë sjellje të mirë e disa jo;
- kërkon nga ata të emërtojnë cila nga këto fotografi tregojnë sjellje të mirë e cila jo;
- bën një pauzë të shkurtër për të sistemuar mendimet e tyre dhe mbresat e nxënësve;
- u tregon se sot do mësojnë vjershën "Sjellja e mirë"; të cilën mësuesi e lexon **në faqen 40 të Tekstit mësimor**;
- vendos në tabelë kartonët ku janë shkruar fjalët: të lutem, faleminderit, urdhëro etj...;
- komentojnë domethënien e këtyre fjalëve më nxënësit duke dhënë shpjegimet e duhura;
- fton nxënësit të zhvillojnë **detyrën 1 dhe 2 në faqen 40 të Tekstit mësimor** duke i ndihmuar në zhvillimin e detyrave;
- kërkon nga nxënësit të vështrojnë vizatimet në **detyrën nr.3 të Tekstit mësimor**, i komenton ato e në këtë mënyrë fton nxënësit të zhvillojnë **detyrën nr.3 në faqen 41 të Tekstit mësimor**;
- bisedon rreth asaj se përse është e rëndësishme sjellja e mirë, pse duhet të sillemi mirë? Çka është sipas teje sjellja e keqe?
- fton nxënësit të zgjedhin një fotografi nga **detyra nr.2** dhe pastaj të aktrojnë situatën e zgjedhur në fotografi;

Vërejtjet e mësues-it/es:

GJERDANI I PËRRALLAVE

Propozim për punë në dyfaqëshen

Të lutem, më trego një përrallë!

Kjo është një ndër frazat më të njohura që dëgjojnë prindërit dhe gjyshërit.

Përrallat gjithmonë do të përfaqësojnë për fëmijët, mjetet përmes të cilave ata njihen me botën e të rriturve. Ato nxisin imagjinatën e fëmijës dhe bënë që mendja e tij të jetë më kreative dhe aktive.

Ilustrimi në **faqen 42 dhe 43 të Teksti mësimor** do t'i fusë nxënësit në botën tërheqëse dhe emocionale të përrallave që ata do të mësojnë në kapitullin e quajtur Gjerdani i përrallave.

Përrallat e këtij kapitulli përshkruhen shkurt, por në mënyrë të thjeshtë, interesante e tërheqëse të shoqëruara me ilustrime, që janë pjesë didaktike e librit të këtyre përrallave dhe element kryesor sidomos për moshën 5-6 vjeçare.

Përrallat në kapitullin "Gjerdani i përrallave" ofrojnë një botë, në të cilën personazhet janë të ndara në të mira dhe të këqija, kanë fuqi magjike dhe për ta gjithçka është e mundur.

Ja disa propozime për ecurinë e punës në zhvillimin e kësaj ore mësimi.

1. Analizë e hollësishme e ilustrimit të paraqitur në **faqet 42 dhe 43 të Tekstit mësimor**;
2. Shpjegon fjalët dhe shprehjet më pak të njohura gjatë kohës kur bënë analizën e ilustrimit dhe ato shkruhen në karton-tabelë;
3. Identifikon personazhet e paraqitura në ilustrim dhe i specifikon ato;
4. Nëse ka ndonjë pjesë më interesante për nxënësit nga ilustrimi, e veçon atë, sepse me siguri do të zgjojë dëshirën e nxënësit për ta ditur në tërësi, përrallën e tyre më të dashur.

Vërejtjet e mësuesit-it/es

KËSULËKUQJA

Vëllezërit Grim

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të bëjë klasifikimin e personazheve të përrallës në personazhe pozitive dhe negative;
- të dallojë përrallat sipas fillimit dhe fundit të tyre stereotip dhe mënyrës së rrëfimit;
- të kuptojë dhe të përdor drejt fjalët shkrimtar dhe titull;
- të zhvillojë aftësinë për të folur qartë dhe saktë duke synuar gradualisht të folurit letrar;

Mjetet mësimore të nevojshme: seria e figurave të përrallës, në shtojcën e Librit të mësuesit.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- u thotë nxënësve, se do t'u tregojë përrallën "Kësulëkuqja" e cila flet për një vajzë që shkoi për vizitë tek gjyshja dhe që s'e dëgjojë këshillën e nënës;
- u thotë, të shohin me vëmendje ilustrimet **në faqet 44 dhe 45 të Tekstit mësimor** dhe të thonë, nëse dinë, për çfarë përralle bën fjalë (**detyra nr.1 në faqen 45 të Tekstit mësimor**);
- bisedon për ilustrimin **në faqen 45 të Tekstit mësimor** duke pyetur: Kë shihni në figurë? Ku ndodhet Kësulëkuqja dhe ujku? Si e ka Kësulëkuqja kësulën? (**detyra nr.2 në faqen 44 të Tekstit mësimor**);
- kërkon nga nxënësit të tregojnë si është ujku (**detyra nr.3 në faqen 44 të Tekstit mësimor**);
- kërkon nga nxënësit të imitojnë zërin e ujkut (**detyra nr.4 në faqen 44 të Tekstit mësimor**);
- bën një pushim të shkurtër për të sistemuar përshtypjet dhe mbresat e nxënësve;
- fton nxënësit, t'u përgjigjen si duhet pyetjeve të **detyrës nr.5 në faqen 44 të Tekstit mësimor**;
- vlerëson dhe saktëson përgjigjet e nxënësve, pa i korrigjuar ata për gabimet dhe për pasaktësitë e mundshme;
- u thotë nxënësve të zhvillojnë **detyrën nr.6, dhe nr. 7 në faqen 45 të Tekstit mësimor** dhe drejton bisedën për të arritur në përfundimet e përbashkëta;
- vlerëson dhe saktëson përgjigjet e nxënësve, pa i korrigjuar ata për gabimet dhe pasaktësitë e mundshme;
- jep vlerësimin përfundimtar për personazhet e përrallës duke pyetur: Kush është "i mirë" dhe kush është "i keq" në përrallë? Pse mendoni kështu?
- u thotë fëmijëve që me ndihmën e më të rriturve të zgjedhin **detyrën nr.8 në faqen 45 të Tekstit mësimor**;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

PRINCESHA ME BIZELE

Hans K. Andersen

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të krahasojë sjelljen e personazheve nga përralla me sjelljen e vet dhe të njerëzve që e rrethojnë;
- të dallojë përrallën në bazë të formës dhe disa tipareve të saj;
- të përshkruajë ngjarjen dhe personazhet e përrallës pavarësisht përjetimit personal;
- të shprehë mesazhin e përrallës duke e vizatuar ose me fjalë;

Mjetet mësimore të nevojshme: seria e figurave të përrallës, në shtojcën e Librit të mësuesit.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- u thotë nxënësve se sot do t'u tregoj përrallën "Princesha me bizele" e cila flet për një vajzë që është shumë guximtare, me të cilën do të njihen në vazhdim pasi mësuesi ta ketë lexuar përrallën;
- u thotë të shohin me vëmendje **ilustrimet në faqen 46 të Tekstit mësimor** dhe i pyet ata nëse e kanë parë ose lexuar ndonjëherë këtë përrallë;
- bisedon për ilustrimet duke i pyetur: Kë shihni në fotografi? Çfarë po bën princesha? Ku është ulur ajo?
- lexon përrallën pjesë-pjesë duke biseduar shkurtimisht me nxënësit;
- ritregon përmbajtjen e përrallës duke i pyetur nxënësit, nëse kanë ndonjë fjalë të panjohur, e nëse ka ua shpjegon ato;
- kërkon nga nxënësi që t'i përgjigjen pyetjes **1 në faqen 46 të Tekstit mësimor**;
- vlerëson dhe saktëson përgjigjet e nxënësve pa i korrigjuar pasaktësitë e tyre;
- u thotë nxënësve të zhvillojnë **detyrën 2 në faqen 47 të Tekstit mësimor** duke u kërkuar atyre të ngjyrosin princeshën në kornizën e dhënë;
- vlerëson dhe inkurajon punën e secilit nxënësi;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

BORËBARDHA

Hans K. Andersen

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë përrallat sipas fillimit dhe fundit të tyre stereotip dhe mënyrës së rrëfimit;
- të dallojë personazhet e "mira" dhe të "këqija" të përrallës;
- të krahasojë përshtypjet e veta për personazhet dhe vendngjarjen, me ato të shokëve;
- të zhvillojë aftësinë për të identifikuar veten me personazhin letrar;
- të kuptojë dhe t'i përdorë drejt fjalët (konceptet) shkrimtar (autor) dhe titull;

Mjetet mësimore të nevojshme: seria e figurave të përrallës në shtojcën e Librit të mësuesit, magnetofoni, CD etj.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- lëshon ndonjë incizim muzikor për të krijuar atmosferë shpirtërore të përshtatshme;
- u thotë fëmijëve, se do të tregojnë përrallën "Borëbardha" që flet për një mbretëreshë shpirtligë e cila është shumë xhelozë për bukurinë e Borëbardhës dhe që është shumë zemër mirë dhe e bukur;
- u thotë të shohin me vëmendje ilustrimet e përrallës në **faqen 48 të Tekstit mësimor** për t'u njohur paraprakisht me personazhet e përrallës;
- fton nxënësit të ulen në rreth dhe u lexon fragmentin e parë të përrallës duke u bërë pyetje: A është e keqe mbretëresha? Pse është e keqe ajo? Po Borëbardha si ju duket? Ku e urdhëroi gjuetarin që ta çojë Borëbardhën?
- dëgjon me vëmendje përgjigjet e nxënësve pa i korrigjuar saktësitë e tyre;
- u thotë nxënësve t'i përgjigjen pyetjes **nr.1 në faqen 48 të Tekstit mësimor**;
- lexon fragmentin e dytë të përrallës në **faqen 54-55 të Librit të mësuesit** dhe bën përsëri pyetje: Ku përfundoi Borëbardha? Kush janë banorët e shtëpisë së re ku jeton Borëbardha?
- A e kuptoi mbretëresha se gjuetari nuk e kishte mbytur Borëbardhën?
- kërkon nga nxënësit t'u përgjigjen pyetjes **nr. 2 në faqen 49 të Tekstit mësimor**, duke ngjyrosur etiketën përkatëse për të fituar përgjigjen e saktë;
- ndihmon nëse duhet në zgjidhjen e **detyrës 2**;
- lexon pjesën e fundit të përrallës duke bërë pyetjet: Si ishte molla që hëngri Borëbardha? Kush ia dha atë? Si përfundon përralla?
- bën një pauzë të shkurtër për të sistemuar përshtypjet dhe mbresat e nxënësve;
- u thotë nxënësve të shikojnë me vëmendje ilustrimin e pangjyrosur dhe të zhvillojnë pastaj **detyrën 3 në faqen 49 të Tekstit mësimor**, e cila kërkon ngjyrosjen e ilustrimit;
- kërkon nga nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht përrallën e mësuar e ta ritregojnë atë shkurtimisht me fjalët e tyre;
- fton nxënësit të vizatojnë sipas fantazisë se tyre të lirë, diçka që u ka pëlqyer më së shumti nga përralla Borëbardha (e nëse koha nuk premton, kërkon nga ata që këtë ta bëjnë si detyrë shtëpie);

Vërejtjet e mësuesit-it/es

Fabul

MIU DHE ELEFANTI

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të shprehë mesazhin e fabulës me fjalë ose duke e vizatuar atë;
- të di të gjejë ngjashmërinë midis vetes dhe personazhit letrar;
- të dallojë fabulën në bazë të formës dhe disa tipareve të tyre;
- të dallojë motivet e sjelljes së personazheve të njohura letrare sipas përvojës vetjake;

Mjetet mësimore të nevojshme: fotografi, ilustrime me kafshët e përmendura në fabul (miu dhe elefanti), lapsa me ngjyrë ose tempera.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- propozon ndonjë lojë dhe shpjegon rregullat e saj;
- vendos në tabelë kafshën: elefantin dhe bisedon për të me nxënësit;
- shton pranë figurës së elefantit figurën e miut dhe bisedon për këtë kafshë me nxënësit;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimin me ngjyra në **faqen 50 të Tekstit mësimor**, duke e komentuar atë;
- u thotë nxënësve se do të tregojë fabulën "Miu dhe elefanti";
- i pyet ata nëse dinë ndonjë fabul të njëjtë me këtë titull apo diçka të ngjashme;
- mësuesi lexon në mënyrë shprehëse fabulën "Miu dhe elefanti" nga **faqja 56 e Librit të mësuesit**;
- bisedon me nxënësit për përmbajtjen e fabulës dhe kërkon nga ata të tregojnë mbresat e tyre pas dëgjimit të leximit nga ana e mësuesit;
- bën një pauzë të shkurtër për të sistemuar përshtypjet dhe mbresat e nxënësve;
- u thotë nxënësve të zhvillojnë **detyrën 1 në faqen 51 të Tekstit mësimor**, ku me bashkimin e pikave do të fitojnë figura të caktuara;
- ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme, në zhvillimin e **detyrës 1 në faqen 51 të Tekstit mësimor**;
- fut në veprimtari nxënësit duke bërë një reflektim mbi fabulën e mësuar dhe bën pyetje:
- Kush është trimi i vërtetë në këtë fabul? Si veproi miu kur elefanti donte ta çonte tek maçoku? A duhet të mburremi dhe ne si miu?
- vlerëson dhe lavdëron përgjigjet e dhëna pa bërë asnjë korrigjim për pasaktësitë e mundshme;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

“MAGJIA E FESTAVE”

Propozime për punën në dyfaqëshën

Festat gjithmonë kanë një magji në vetvete dhe shpirtin festiv, e ato që e ndiejnë më shumë këtë gjë janë fëmijët, prandaj dhe ilustrimet **në faqen 54, 55 të Tekstit mësimor** shërbejnë si hyrje për kapitullin e ri të titulluar “Magjia e festave”.

Ato, me pamjet e ndryshme, u tërheqin vëmendjen fëmijëve për festat e tyre më të dashura por dhe për festat e të afërmeve të tyre siç është festa e nënës. Lirisht mund të themi se këto festa e bëjnë shpirtin dhe mendjen e fëmijës më kreativ dhe u shërbejnë si model edhe për festat e tyre të shumta.

Në ilustrimet e shumta të paraqitura në tekstet letrare, nxënësit do të ndeshen me ilustrime shumë tërheqëse që do nxisin kureshtjen e tyre për të ditur se çfarë do të mësojnë gjatë punimit të pjesëve të teksteve letrare të këtij kapitulli.

Atë që mësimdhënësi mund të bëjë paraprakisht, para se të fillojë përpunimi i këtij kapitulli, është se ata mund të lajmërojnë paraprakisht nxënësit për këto pjesë, me qëllim që ata të propozojnë e të përgatisin ndonjë projekt lidhur me festat që do të presin, për ç’gjë do të duhet ndihma e prindërve.

Ja propozimi ynë për ecurinë e punës në zhvillimin e orës së mësimi të punimit të kësaj dyfaqësheje të ilustruar:

1. Mësuesja (mësuesi) bënë analizën me radhë të pjesëve të ilustrimit, gjithmonë duke përfshirë edhe nxënësit në këtë analizë (bashkëpunimi: nxënës-mësues);
2. Mësuesja shkruan në karton - tabelë fjalët: VITI I RI, TETË MARSI etj.;
3. Nxënësit dallojnë dhe emërtojnë festat e ndryshme të paraqitura në figura;
4. Mësues-i/ja tregon gjëra interesante për festat me çfarë zgjon interesimin e nxënësve për të ditur dhe për të treguar edhe vetë më shumë për to;
5. Mësues-i/ja nxit nxënësit, që në mënyrë të lirë, të paraqesin me vizatim festën e tyre më të dashur;
6. Mësues-i/ja nxit nxënësit që të rrëfejnë me gojë si e festojnë ata festën më të dashur të tyre ose të recitojnë ndonjë vjershë lidhur me ndonjë festë që duan më shumë;

VITI I RI

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të dallojë dhe të përjetojë melodinë e vjershës gjatë leximit shprehës;
- të zhvillojë aftësinë për asocim gjatë dëgjimit të leximit të vjershës;
- të dallojë dhe të veçojë fjalët që rimojnë në vjershën Viti i Ri;
- të kuptojë dhe të përdorë drejt fjalën titull;
- të shprehë me fjalë ose me vizatim ndjenjat e veta gjatë dëgjimit të leximit të vjershës;

Mjetet mësimore të nevojshme: stenda e madhe në të cilën në kuadër të përgatitjes së projektit, përgatitet bredhi i Vitit të Ri me zbukurime të ndryshme, gërshtë, karton, lapsa me ngjyra ose bojëra tempera, tullumbace, pambuk etj.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- i fton nxënësit, që me tekstin mësimor në duar, të mbledhen para bredhit të Vitit të Ri të cilin e kanë përgatitur paraprakisht gjatë javës projektuese;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimin me ngjyra në **faqen 56 të Tekstit mësimor** dhe të krahasojnë bredhin e Vitit të Ri të paraqitur aty me bredhin që kanë përgatitur ato vetë;
- lexon në mënyrë shprehëse vjershën "Viti i Ri" në **faqen 56 të Tekstit mësimor** duke u ndalur veçmas në shpjegimin e titullit të saj;
- bën një pauzë të shkurtër për të sistemuar mbresat e nxënësve;
- e lexon dhe një herë vjershën dhe bisedon duke pyetur nxënësit: Për çfarë bëhet fjalë në këtë vjershë? Kur e festojmë Vitin e Ri? Si vjen Viti i Ri? Kush gëzohet më shumë për ardhjen e Vitit të Ri?
- sqaron dhe shpjegon fjalët dhe shprehjet e pa njohura ose më pak të njohura, si: kapërcen, pakëz, botë, përshkon, balerinë, shteg etj.;
- i fton nxënësit të vizatojnë si e kanë stolisur bredhin e Viti të Ri në shtëpi ose në klasë (**detyra 1 në faqen 63 të Tekstit mësimor**) dhe pas saj edhe çdo gjë që u kujton Vitin e Ri (dhuratën me të bukur, babagjyshin, borën), (**detyra 2 dhe 3 në faqen 57 të Tekstit mësimor**),
- po ashtu nëse di të shkruajë ose të thotë gojarisht si urojmë për Vit të Ri;
- kontrollon punën e nxënësve, i udhëzon dhe u ndihmon, nëse është e nevojshme, por pa ndikuar në propozimet e veta në shprehjen e lirë figurative të fëmijëve;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

DITË DIMRI

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të kuptojë realitetin e pasqyruar në tekstet letrare dhe të zhvillojë aftësinë për t'i paraqitur ato në mënyra të tjera;
- të zhvillojë aftësinë për asocim gjatë dëgjimit (leximit) të vjershës;
- të veçojë strofën e vjershës që i ka pëlqyer më shumë;
- të njohë dhe të përdorë fjalë dhe shprehje të reja;

Mjetet mësimore të nevojshme: pjesë nga revistat që paraqesin dimrin, magnetofoni, CD me incizime të përshtatshme muzikore, ilustrime me pamje dimërore etj.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- bisedon me nxënësit për stinën e dimrit dhe për borën, që bie në këtë stinë, të cilës fëmijët i gëzohen shumë;
- u propozon nxënësve të këndojnë ndonjë këngë për dimrin (nëse dinë);
- u thotë nxënësve, të shohin me vëmendje ilustrimin me ngjyra në faqen 58 të Tekstit mësimor dhe të tregojnë çfarë shohin dhe çfarë u pëlqen në të;
- lexon vjershën "Ditë dimri" në **faqen 58 të Tekstit mësimor** duke u ndaluar veçmas në shpjegimin e titullit të saj,
- bën një pauzë të shkurtër për të sistemuar mbresat e nxënësve;
- lexon dhe një herë vjershën dhe bisedon me nxënësit duke i pyetur: Si është stina e dimrit? Pse kërkon fëmija që të flasë me dimrin? Çfarë na sjell dimri? Çfarë bëjnë fëmijët në borë? Pse ua ngrin duart? Pse nuk e kanë frikë fëmijët dimrin?;
- sqaron dhe shpjegon fjalët më pak të njohura për nxënësit si: tufan, stuhi, pallto, të zënë prej dore, ashpër, plakun prej dëbore, guximtar etj.;
- i fton fëmijët që sipas dëshirës të tregojnë çfarë dinë për dimrin dhe i fton të vizatojnë rrobat e dimrit (**detyra nr.1 në faqen 59 të Tekstit mësimor**);
- u thotë nxënësve që të zhvillojnë **detyrën nr.2 në faqen 59 të Tekstit mësimor**;
- kontrollon punën e nxënësve, i udhëzon dhe u ndihmon, nëse është e nevojshme, por pa ndikim në mendimet dhe shprehjet e lira të tyre;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

FESTA JOTE, FESTA IME

Adelina Mamaqi

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të dallojë dhe të përfjethë melodinë e vjershës gjatë leximit shprehës;
- të zhvillojë aftësinë për asocim gjatë dëgjimit të leximit të vjershës;
- të kuptojë dhe të përdorë drejt fjalën titull;
- të njohë dhe të përdorë fjalë dhe shprehje të reja

Mjetet mësimore të nevojshme: ilustrime me figurën e nënës, gjyshes me buqeta lulesh në duar, fleta A4 me buqeta lulesh të vizatuara të pangjyrosura, lapsat me ngjyra ose tempera akuarel, magnetofon me CD me incizime.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- lëshon sipas dëshirës një incizim muzikor me këngë kushtuar nënës;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimet e përgatitura nga mësuesi ku shihet një grua me buqeta me lule në duar dhe i fton nxënësit të komentojnë ilustrimet;
- dëgjon pa korrigjuar mendimet e nxënësve dhe nëse ka ndonjë pasaktësi;
- fton nxënësit të shikojnë me vëmendje ilustrimin në **faqen 60 të Tekstit mësimor** dhe të tregojnë se çfarë shohin në të;
- lexon në mënyrë shprehëse vjershën "Festa jote, festa ime" në **faqen 60 të Tekstit mësimor** duke u ndalur veçmas në shpjegimin e titullit të saj;
- bën një pauzë të shkurtër për të sistemuar mbresat e nxënësve,;
- rilexon vjershën duke pyetur: Për çfarë bëhet fjalë në vjershë? Për cilën festë flitet? Kush e feston këtë festë? Çfarë dhurate i bën ti nënës për këtë festë? Cili është urimi që bën ti me rastin e festës së Tetë Marsit?
- u thotë nxënësve të zhvillojnë **detyrën numër 1 në faqen 60 të Tekstit mësimor**, ku kërkon nga nxënësit të vizatojnë në hapësirën brenda kornizës dhuratën që ata i sjellin nënës për festën e Tetë Marsit;
- kontrollon punën, udhëzon dhe ndihmon, nëse është e nevojshme pa ndikuar në shprehjen e lirë figurative të nxënësve;
- në **faqen 61 të Tekstit mësimor**, në **detyrën nr.3** kërkon nga nxënësit që si detyrë shtëpie të vizatojnë personin më të dashur për të dhe veten;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

NJË QERSHORI

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zhvillojë dëshirën dhe aftësinë për të dëgjuar tekste letrare artistike;
- të dallojë dhe të përjetojë melodinë e vjershës gjatë leximit shprehës;
- të zhvillojë aftësinë për asocim gjatë dëgjimit të leximit të vjershës;
- të kuptojë dhe të përdorë drejt fjalën titull;
- të tregojë a i ka pëlqyer vjersha;

Mjetet mësimore të nevojshme: globi i punuar në javën projektuese, në të cilin janë vizatuar ose ngjitur fotografite e fëmijëve që kërcejnë në valle, magnetofoni me CD me incizime këngësh për fëmijë.

Veprimtaritë e MËSUES-IT/ES:

- u flet nxënësve për festën e Një Qershorit, festë e fëmijëve të mbarë botës;
- u propozon nxënësve që të dëgjojnë ose këndojnë ndonjë këngë që dinë për festën e Një Qershorit;
- u thotë nxënësve të shohin me vëmendje ilustrimin me ngjyra në **faqen 62 të Tekstit mësimor** dhe të përshkruajnë atmosferën e gëzuar të paraqitur në të;
- lexon vjershën "Një Qershor" në **faqen 62 të Tekstit mësimor**, duke u ndalur veçmas në shpjegimin e titullit të saj;
- sqaron dhe shpjegon fjalët dhe shprehjet e panjohura ose më pak të njohura si: gonxhe, zambak, festë, vocërrak, krahëlehtë etj.;
- bën një pauzë të shkurtër për të sistemuar mbresat e nxënësve;
- rilexon vjershën dhe bisedon duke pyetur nxënësit: Festa e kujt është Një Qershor (detyra nr.1 në **faqen 62 të Tekstit mësimor**);
- u sqaron nxënësve si të zhvillojnë **detyrën nr.2 dhe nr.3 në Tekstin mësimor** (duke kërkuar ndihmën e prindërve ose të të rriturve), në **faqen 63 të Tekstit mësimor**,
- kontrollon punën e nxënësve, i udhëzon dhe u ndihmon, nëse është e nevojshme, por pa ndikuar në asnjë rast me mendimet e veta në shprehjen e lirë e figurative të tyre;

Vërejtjet e mësuesit-it/es

PROPOZIME PËR PUNËN NË DYFAQËSHEN "SA BUKUR KËTU"

Pas çdo pune të menduar mirë e të realizuar gjithmonë mungon një sistemim i mirë. Vetë fjala sistemim do të thotë ndërthurje, vendosje bashkë, prandaj si i tillë sistemimi është veprimtari e domosdoshme dhe e pashmangshme e punës mësimore. Pikërisht për këtë, janë dhënë ilustrimet në faqen **64–65 të Tekstit mësimor**.

Vendin kryesor në ilustrim në **faqen 64** e zë figura e një nxënësi ose nxënëseje e cila na ka shoqëruar gjatë gjithë vitit shkollor në mësimin e lëndës së Letërsisë. Ai (ajo) mban në duar 6 tullumbace dhe vrapon e (i) lumtur. Në gjashtë tullumbacet janë dhënë ilustrime me pamje të ndryshme që simbolizojnë gjashtë kapitujt e lëndës së Letërsisë dhe ai (ajo) duket se shqipton fjalët SA BUKUR KËTU, pra në shkollë.

Kërkon nga nxënësit të shikojnë ilustrimet dhe kërkon nga ata të thonë, pse nxënësi është i lumtur në fund të vitit shkollor, pse ai mban këto ilustrime në tullumbacet e tij tani në fund të vitit dhe jo më parë. Çka ka dashur të na bëjë me dije ai përmes atij mesazhi? Në dorën tjetër ai mban një tullumbace tjetër me mbishkrimet: **gjej, recitoj, shtjo, lexoj, shkruaj, flas, ngjyros...**

Nga ato mbishkrime, nënkuptojmë se nxënësit e klasës së parë tash më në shkollë kanë mësuar: **të ngjyrosin, të gjejnë, të recitojnë, të shtojnë, rrumbullakojnë e ndoshta edhe të lexojnë**. Prandaj rekomandohet që faqja e dytë e këtij ilustrimi të ketë ilustrime ku nxënësit të kenë detyra të ngjisin, të ngjyrosin, të shtojnë, rrumbullakojnë etj. Këtij kapitulli mund t'i shtohen dhe filmat vizatimorë, ku sugjerohet të shikohen disa, sepse për nxënësit e klasës së parë, atmosfera që krijon shikimi i një filmi vizatimor në shkollë sjell tek ata atmosferën e ngrohtë të shtëpisë ku filmat vizatimorë janë pjesë e pandashme e tyre e kështu nxënësit udhëtojnë në botën e fantazisë dhe në botën përrallore që vetëm filmi vizatimor mund të na shpie. Disa udhëzime për këtë pjesë të kapitullit mund të jenë: nxënësit shikojnë filmat vizatimorë më të dashur për ta, i analizojnë personazhet, shkruajnë, nëse dinë titujt ose personazhet, flasin për ta dhe i vizatojnë.

Nga porosia që jep vajza (djali) që është: SA BUKUR KËTU e kuptojmë se nxënësit i kanë përvetësuar tashmë plotësisht njohuritë, shkathtësitë, shprehitë e parashikuara në Programin mësimor për lëndën Gjuhë amtare dhe letërsi për nxënësit e klasës së parë të shkollës fillore.

Arritja e i mësimi të gjuhës amtare dhe letërsisë për klasën e parë është përvetësimi i shkathtësive për të komunikuar në situata të ndryshme komunikuese, përgatitja e nxënësve që në vitin e ardhshëm ta përdorin gjuhën standarde. Ajo synon t'i mësojë nxënësit për një zhvillim të dëgjimit të vëmendshëm, për zhvillim dhe pasurim të fjalorit dhe të folurit.

Punimin e kësaj faqeje mësuesi/sja mund ta realizojë jo vetëm në fund të vitit shkollor, por edhe pas kapitujve të veçantë të Tekstit mësimor.

I.
TEKSTE JOLETRARE

KALI

Në të kaluarën njerëzit transportimin e mallrave e kanë bërë me kalë. Kali është një kafshë shtëpiake shumë e bukur dhe e dashur. Ai dallohet nga kafshëte tjera bartëse (gomari dhe mushka) sepse në qafë ka jele.

Kalin e shfrytëzojmë edhe në gara për kalërim. Trupin e ka të lëmuar dhe është shumë i bukur.

MOLLËKUQJA

Mollëkuqja është një kandërr e vogël, e kuqe me pika të zeza. Vendbanimi i saj është në gjethe, në livadhe zakonisht. Ajo ha gjethe të vogla dhe mund të qëndrojë disa ditë pa ngrënë. Mund të qëndrojë në ambiente të mbyllura, por shpesh herë e shohim në natyrë ose fusha me pemë dhe bar. Quhet ndryshe dhe nusepashkë. Mollëkuqja mund të jetë e kuqe, e verdhë dhe e gjelbër.

QUKAPIKU

Qukapiku është një zog i pyllit, i cili dallohet për nga sqepi i tij i gjatë. Trupin e ka të mbuluar me pendë me ngjyra të ndritshme. Ai ushqehet me krimba dhe insekte të ndryshëm që jetojnë në lëkurën e drurëve. Është interesante fakti se ai me sqepin e gjatë e qukat lëvoren e drurit, buburrecat dalin të shohin se çfarë u bë dhe ai i gëlltit. Ndryshe qukapiku quhet pastrues i insekteve dëmtues të drurëve.

BLETA

Bleta është insekt i dobishëm. Bleta prodhon mjaltin.

Në popull përdoret shprehja "punëtore si bleta".

Trupi i bletës është i vogël me ngjyrë pak a shumë të murrme dhe të mbuluar me push. Bleta jeton në koshere. Mjaltin e mbledh nga poleni i luleve. Dobitë që sjell bleta janë të shumta.

LEPURUSHI

Lepurushi është kafshë e egër që jeton në pyll. Lepurushi ka kokë të rrumbullakët dhe veshë të gjatë. Trupin e ka të mbuluar me qime me ngjyrë të murrme. Këmbët e prapme i ka më të gjata se këmbët e përparme, prandaj mund të vrapojë shpejt. Lepurushi njihet si kafshë shumë frikacake. Ka po ashtu edhe lepuj të zbutur nga njeriu.

LOPA

Lopa është kafshë shtëpiake të cilën njerëzite mbarështojnë për t'u dhënë qumështin, mishin dhe plehun.

Ka trup të madh. Në kokë ka brirë. Ka lopë dhe pa brirë, e që i quajmë lopë shyta. I vogli i lopës është viçi.

DELJA

Delja është kafshë shtëpiake e imët. Mbarështohet në kope. Trupin e ka të mbuluar me lesh. Në verë barinjtë i qethin delet. Leshi përdoret në industrinë e tekstilit për përpunimin e materialeve të ndryshme për veshje, për amvisëri (qilima, tepiha) etj. Delja na jep qumësht, mish dhe lesh. I vogli i deles është qengji.

II. TEKSTET LETRARE

HPADOLLAPA

(popullore)

Hapadollapa,
Kush është mbrapa,
Se më zuri vapa,
Vapa e korrikut,
Nën hije t'fikut,
Huj e pt-huj!

Mehmet Ali Hoxha

ÇFARË THONË KAFSHËT

Gjeli këndon ki, ki, ki
Na thotë: zgjahuni fëmijë!

Macja bën: mjau, mjau
Shihni Lecin, sytë i lau

Qengji blegëron: be, be, be
Na thotë: mësoni sot si dje

Zogu cicëron: ciu, ci
Shkoni n'shkollë, o fëmijë!

Nexhati Tafa

HYJO, KALO

Hyjo kalo ato jele,
Kush t'i thuri kaçurrele?
Hyjo kalo hihhi
E çdo bëjmë në shtëpi? Në shtëpi s'na rrihet sot, Hyjo kalo trok, trok, trok. Hyjo kalo hihhi
Hyjo kalo hingëlli.
Hyjo kalo, ato jele
Unë t'i thura kaçurrele.

Nexhati Tafa

MOLLË E KUQE

Mollë e bukur kuq e zi,
Në ëndrrën time endesh ti. Vij tek ti mollë e vogël,
Të ndjek në udhë, Humbas në lodër
Mollë e kuqe me pika shumë, Ti hapë krahët pas vij unë.
Çelë në ëndërr si burbuqe
Rënd pas ëndrrash mollë e kuqe.

LUMI

U, u, u ja bën lumi,
Bo, bo, bo se zë gjumi,
Shkon në det për t'u larë,
S'ka peshqir për t'u tharë.

Adelina Mamaqi

QUKAPIK, O QUKAPIK

Qukapik, o qukapik
të kam shok e të kam mik
Pik-pik-pik ç'po bën kështu?
Gëlltis krimba, dru më dru.

Krimbin unë e kam armik,
sepse është shumë i lig
Se ha gjethe e lëkurë,
nëpër lule, nëpër drurë.

Xhahid Bushati

DIELLI DHE REJA

I gëzuar dielli udhëtonte në qiell me karrocën e zjarhtë, duke lëshuar rrezet e tij në tokë. Çdo fije bari, çdo lule, çdo pikë uji, çdo gjë merrte rrezet e tij. Një re e zezë pëshpëriste tërë inat:

– Thatësirë duarthatë, po i lëshove kështu rrezet e tua, do të shohësh sa pak rreze do të të mbeten.

Dielli nuk ia vente veshin. Reja nuk po pushonte:

– Lëri, lëri të t'i marrin të gjitha.

Rrezet do të mbarohen dhe askush nuk do të të falënderojë.

Dielli vazhdonte të dhuronte me kënaqësi rrezet e tij, pa u shqetësuar. Kur po perëndonte, Dielli i numëroi rrezet. Nuk i mungonte asnjë.

Xhevat Beqaraj

O YLBER I BUKUR

Me të shtatë ngjyrat
Harkun tënd po thur.
O ylber i bukur,
Më dukesh si urë.

Lart të ngjitem, lart
Sipër teje dua.
Në ç'brigje mbështeten
Këmbëzat e tua.

Gordon Volke dhe Dudley Mosoleu

MIQTË E PYLLIT

Në këmbët e një gështenje jetonte një kërpudhë e madhe, me kësulë të kuqe me pika të bardha.

Nën kërpudhë jetonin të lumtura tri mikesha: mollëkuqja, milingona dhe larva.

Erdhi dimri. Kërpudha nuk i mbronte dot nga të ftohtët. Mikeshat vendosën të shkonin të trungu i gështenjës. Po si t'i thoshin kërpudhës se po largoheshin?

Ajo do të mërzitej.

Bënë si bëjnë dhe një ditë i thanë. Morën rrobat dhe u larguan.

Por shoqet nuk e harruan kërpudhën. Ato shkonin çdo ditë dhe përshëndetnin atë. Kështu, kërpudha nuk u ndie e vetmuar.

BLETA

Nëpër lule shkon e vjen,
Bletë e vogël mbledh polen,
Mjaltin, dyllin na gatuan,
Prandaj shumë ty të duan.

Hajro Ulqinaku

VJERSHA E KALTËR

Vera ka ngjyrën e kaltër.
Deti, i kaltër,
Mbi, qielli i kaltër,
Në zemër të detit të kaltër
Notojnë peshqit e kaltër.
Në detin e kaltër
Peshkatarët zënë peshq të kaltër.

Gaqo Bushaka

DERRKUCI KAPET "ROB"

Mollët lëshonin një aromë të këndshme. Ato qenë skuqur dhe ishin mbushur me lëng... dhe çfarë lëngu, mjaltë i ëmbël dhe akull i ftohtë. Tamam mollë Korçe. Ariu Zebo u soll rreth trungut disa herë me kokën përprjetë, po nuk hipi që nuk hipi dot. Barku i rumbullakosur sa dy tullumbace bashkë ishte një pengesë serioze për të shijuar frutat e mrekullueshme. Mirëpo, edhe që të ikte pa i shijuar ato mollë bukuroshe e të pjekura për merak, nuk i bënin këmbët. Së fundi e gjeti zgjidhjen: mbështeti putrat e para në trungun e lyer me gëlqere dhe e tundi e shkundi sikur donte ta shkulte nga rrënjët. Së bashku me mollët e arrira e gjethet kuqaloshë ra dhe ... cili thoni ju ?...derrkuci Çufo. Megjithëse iu shembën mollaqet, Çufoja u ngrit e desh t'ia mbathte me vrap si t'i dinte vërtet vlerat e proverbit "Këmbët e lehta, faqja e bardhë", por Zeboja, që as e dinte se ku e ka shtëpinë faqja e bardhë, e mbërtheu prej veshi.

– Ej, lëshomë! Lëshomë, se po më ndalon qarkullimin e gjakut! – thëriste Çufoja syzgurdu-ltuar si vezë syze.

Po Zeboja, që ndeshej në udhëkryqin mes inatit dhe kënaqësisë, i shfryu:

– Më duket se po të ndaloj qarkullimin e mollëve, more b...u...k...u...r...o...sh! Ç’ deshe sipër mbi mollë? Eëë?!

Po merrja një sy gjumë.

– E tmerrshme! – ulëriu ariu. – Po pse gënjen, more vogëlush?

– Ma do trupi.

– Ta do trupi, ëë? Guxon të tallesh me mua, se pandeh që s’kam hipur ndonjëherë në pemë.

– Puna jote ajo ...unë nuk them gjë.

– Fol... ç’deshe mbi mollë? Mos ma dridh, se do nxehem më shumë.

– Flija, dhe këtë ta them singerisht. Nuk di përralla unë...ti po deshe nxehu, por nuk bën mirë për shëndetin.

Zeboja vuri duart në mes.

– Po flije, ëëë? Po pse, në këtë orë fle zotrote?

– Unë fle në çdo orë, të qafsha ty nëse të gënjej!

– Hesht!

– Vetë me pyete.

– Domethënë për të fjetur u ngjite!

– Tamam, s’e luan as topi. Mbrëmë na erdhi për darkë Gjinkalla dhe na mbajti me llafe gjer në agim. Nuk i pushonte goja, sikur të kishte ngrënë disqe CD në vend të petullave.

Askush s’ia kalon kur fillon të tregojë përralla me shtriga dhe vër kopan.

– Mbylle! Pse nuk flete në shtëpi ose mbi barin e butë, po gjete vend tamam mbi mollën time të mirë?...Fol de!

– Ti më the të hesht!

– Hesht kur duhet të heshtësh dhe fol kur duhet të flasësh.

– Pikërisht këto unë i kam ngatërruar gjithmonë shumë keq...

– I ngatërron, ëëë?... – Ai e mbërtheu prapë nga veshi i majtë sikur të mos ishte vesh, po parafango kamioni.

– O! O! Do ma këputësh veshin!

– Përgjigju!

– Fjeta mbi mollë që të mos pengoja milingonat, që kaliteshin hip e zdryp për të mbledhur sa më shumë ushqime për dimër.

– More, po unë gjer sot ju kam ditur për leshko ju derrkucëve, po ja që të dhënkeni ujë me bisht të lugës!

– E, si urdhëron, u japim atyre që e pinë...

– Pusho! I paedukuar!

– Ah, këtu e ke gabim, sa për edukatë s’ma kalon njëri në shkollë. Pyet kë të duash.

– Tani që do vemi bashkë në shkollë, do ta shohim atë punën e edukatës sate.

– Ja, shko pyet vetë, unë kam besim të madh te ti, – i tha derrkuci si pa gjë të keq.

– Bashkë, ore bukurosh, bashkë do të shkojmë. Mbaje në xhep besimin tënd, mbase të hyn në punë gjëkund.

– Vemi ku të duash, po jo sot, se kam pushim.

– Pse? – pyeti i habitur ariu Zebo. – Sot nuk është e diel.

– A, lëre se ç’na ka ndodhur: mësuese Mjellmën e ka zënë “gripi i pulave”! Thuhet se e ka punën keq, aq keq, sa vjell nga hundët copa kaçkavalli.

– Hajde të gënjyer që bëke, more qerratai i xhaxhait!

Specialist qenke për këtë punë. Po unë mësuese Mjellmën e takova qëparë tek udhëkryqi.

Ishte me Bubin Kaçurrel.

– E pra, – fërkoi duart i gëzuar Çufoja, ajo po shkonte në poliklinikën e pyllit. Gjersa që te udhëkryqi, domethënë mund të shkonte në të majtë, mund të ecë drejt, mund të merrte nga e djathta, ose po të dëshironte, mund të kthehej dhe mbrapsht...

- Ariu i inatosur, ia kapi të dy veshët Çufos dhe ia afroi hundën pranë hundës së vet.
- Ato që të di ty koka, mua m’i di hunda, o buçko! Unë e pashë, morri rrugën e shkollës.
 - Mbase vajti të merrte leje... – tha Çufoja.
 - Pusho!

Atë çast një degë e fuqishme pishe u përkul tamam mbi kokën e Çufos. Halat e gudulisën keq dhe ai, që t’u shpëtonte thumbave të tyre, filloi të përdridhej: “Po u bie shumë në qafë fëmijëve të mi”, fishkëlleu pisha me gjuhën e halave. Zeboja e kuptoi, si dukej edhe fidanët e rinj nuk i linte rehat, ky derrkuc i prapë, prandaj e kapi për zverku e i tha:

– Hajde, t’u mbylltë, hajde, as fidanët nuk i paske lënë të qetë. Edhe për këtë do t’u them në shkollë, për shpirt të nënës!

Ariu e tërhoqi fort Çufon:

– Ej, avash, – u ankua derrkuci. – Nuk ke turp, alamet ariu e merresh me një copë derrkuc të përgjumur! Shiko po nuk u tallën të gjithë me ty, sa të arrish në shkollë.

– Atë do ta shohim, po ti vetëm ec.

Kështu derrkuci Çufo, i kapur “rob”, deshi s’deshi u nis drejt shkollës me zemër të lënduar, duke kujtuar shpotitë e shokëve dhe qortimet e mësueses Mjellmës, që e bëri të sëmurë.

Në klasë dalëngadalë u shuan pëshpëritjet. Nëpërmjet dritareve të mëdha futeshin cicërimat e zogjve këngëtarë, që luanin “e kush e ka” mbi gjethet e vjeshtës, dhe drita e diellit.

Mësuese Mjellma u hodhi një vështrim ledhatues nxënësve dhe buzëqeshi e kënaqur: ata e mbanin trupin drejt, ishin krehur për bukuri; shkëlqenin nga pastërtia dhe shikonin plot dashuri mësuesen. Me bisht të syrit Mjellma pa me kënaqësi se edhe lepuri i fshiu hundën me një shami të pastër ngjyrë trëndafili. Ndoshta lepuri enkas e nxori atë çast shaminë, që t’ia shihte mësuesja.

Mjellma, e gëzuar u ul në karrigen prej dru lisi dhe shfletoi regjistrin. Atë e kishin mbështjellë për merak sorkadhet me një letër si cipë mështekne. Mbi të Pelikani, që shquhej për shkrimin e tij të bukur, kishte shkruar: Shkolla “Rrezet e arta”, klasa III C.

Mësuese Mjellma u hodhi një sy emrave në faqen e regjistrit, ndërsa nxënësit po pritnin në heshtje, pastaj tha me zërin e saj përkëdhelës:

– Të ngrihet në mësim derrkuci Çufo.

Një pëshpëritje kaloi bankë me bankë dhe humbi tej nga dritarja.

Atë çast, në klasë u dëgjuan tri të trokitura: tak, tak, tak. Të gjithë vështruan nga dera. Kurmria hapi derën dhe në klasë hyri ariu Zebo me Çufon për dore.

– Paska rënë rob Çufoja! – qeshi Lejleku.

– Çufoja nuk i ngrinte sytë. Ai ishte mbledhur grusht dhe qe zbehur.

– Më falni, zonja mësuese, – tha Ariu Zebo, – që jua preva mësimin. Erdha vetëm t’ju sjell këtë bukuroshin, të cilin e gjeta mbi mollën time.

– Nën mollë, mësuese, se ky më kapi kur unë u hodha vetë, – e ndreqi Çufoja.

Në klasë shpërthyen nja dy-tri të qeshura si fishekzjarre me ngjyra, po mësuesja i shikoi me vështrimin e saj të rreptë.

– Le, po më tha që sot nuk ka njëri në shkollë. Ju qenkëshit sëmure nga “grip i pulave” dhe villni nga hundët copa kaçkavalli!

– Pse kështu, Çufo? – e pyeti mësuesja e mërzitur.

– Tha se kishte hipur për të fjetur, mirëpo barku i tij i rrumbullakosur tregonte se tërë kohën kishte ngrënë...

Në klasë prapë shpërthyen ca të qeshura, por tani si kuitje.

– Eh, Çufo, Çufo, – pëshpëriti Mjellma, – kur do zësh mend ti?

– Fundja unë, mësuese, hëngra ca, kurse ky i shkundi të bëra dhe të pabëra. Ka lënë gjithë familjen pa mollë...

– Po ajo është molla ime, zonja mësuese...!

– Epo ju, zoti ari, nuk duhej ta shkundte aq fort, se e pate, si ngjau! – foli me shpoti Mjellma.

– Duhet të sillnit dhe ca mollë si provë materiale, – tha Tipi.

– Që të haje edhe ti, – i tha Mjellma.

– Mua m’i ka ndaluar doktori para buke...

Kërriçi qeshi me zhurmë, sa u tund llambadari si kek, që varej nga tavani i bardhë.

Qetësi! Qetësi! – tha Mjellma dhe u kthye nga ariu. – Na falni, zoti ari, për dëmin që ju shkaktoi nxënësi i klasës sonë Çufoja.

Ne do të merremi më seriozisht me të. Nuk mban ujë orizi.

– Të kuptohemi, – tha ariu, – unë nuk e bëra këtë për ca mollë, por...

– Lëre, se për mollë e bëra. Në gjithë fisin tonë të arinjve ti je mollështrenguari, me falni, më dorështrenguari.

– Kush foli aty? – pyeti mësuese Mjellma. Arush Tipi uli kokën dhe nuk e zgjati më, ndërsa Zeboja vazhdoi:

– ... sepse ky duhet të vijë në shkollë dhe jo të bredhë poshtë e përpjetë. Mirupafshim, mësuese, dhe na urdhëroni nga shtëpia.

– Faleminderit.

Ariu Zebo fshiu djersën dhe doli nga klasa i lehtësuar.

Mësuesja ia bëri me kokë Çufos dhe ai shkoi kokulur në bankën e vet.

– Hëngre vërtet sa u ngope? – e pyeti shoku i bankës, arush Tipi.

– U shqepa.

– Toke këtu. S’ka gjë se mësuesja të bëri oriz... Ata i shtrënguan dorën njëri-tjetrit..

– Vazhdojmë mësimin, – tha mësuese Mjellma. – Le të ngrihet Bubi Kaçurrel. Bubi u ngrit dhe doli përpara tabelës së zezë me librin e leximit në dorë.

– Ti do të na flasësh se ç’bëri Dhelpra me rrushtë. Bubi nisi të fliste shtruar:

– Në përrallën thuhet se, pasi zonja Dhelpra nuk i arriti rrushtë, tha se nuk i donte, meqë ishin të pabëra. Por e vërteta sot nuk është ashtu...

– Si është?

– Dhelprat tani janë bërë më dhelparake; ato, po t’i lësh të kapin me kërabë dhe e kullufisin rrushin e pjekur pa lënë kokërr.

Mbase kështu bëjnë vetëm dhelprat e pyllit tonë, po ma do mendja se të gjitha një turi kanë. Pra janë dhelpra që kultivojnë dhelperi.

Mjellma e pa me dashuri Bubin Kaçurrel dhe i vuri notën dhjetë.

Në orën e aritmetikës mësuese Mjellma thirri në mësim ariu Tipi. Një “ah” shumë i dhembshëm doli nga thellësia e një banke. Mjellma e shqetësuar zgjati qafën e saj të bukur dhe çfarë i panë sytë, thoni ju. Arushi Tipi i kishte mbetur koka nën bankë, pikërisht te vendi ku vihen çantat. Kuptohet që Tipi i ngratë ishte futur aty për t’u shpëtuar syve të mësueses, po harroi se mësuesja ka përpara regjistrimin, si pasqyrë të mrekullueshme, ku ajo shikon shumë gjëra.

Mjellma priti me durim gjersa arushi doli sumbullosur në djersë të ftohta në hapësirën në mes dy rreshtave me banka. Arushi rregulloi pak balluket ngjyrëgështenjë dhe u nis drejt dërrasës së zezë, i përcjellë nga ngacmimet e kumrive: “Tani do shohim gallatë”. Po arushi s’para pyet fort. Ai mbështeti putrën në numërorin ngjyra-ngjyra, që e përdorin vogëlushët për të mësuar aritmetikën.

Kur e pa mësuesen në sy, sesi i erdhi dhe u skuq. Ai mezi mundi të shqiptonte:

– Po kërkoja stilolapsin, mësuese:

– E gjete?

– Jo. Do ta kem lënë në shtëpi, ose...

– Bën mirë që t’i përgatitesh përpara ato gjëra që të duhen për shkollë, ndryshe asnjëherë nuk do ta kesh vëmendjen në mësim.

– Nuk është faji im, mësuese, motra e vogël gjithmonë më ngacmon çantën. Sa herë e qor-

ton nëna për këtë shkak, po ku pyet ajo llasticë!

– Y, çfarë gënjeshtari! – i klithi mbyturazi Ketri shokut të bankës. – Ai nuk ka fare motër.

– Shëët, se të dëgjon mësuesja, – i ra lepurit me bërryl dhe shtoi: – Sikur nuk e dimë ne se, për sajime, arushi me Çufon zënë vendin e parë në pyll.

Ketri buzëqeshi.

Mirë, – tha mësuesja – tani për tani nuk duhet stilolapsi, se do të shkruash me shkumës.

Dëgjo më vëmendje problemin. Ju të tjerët do ta zgjidhni në fletoren e klasës. “Një ditë, një bletë shumë e shkathët mbledhi nektar për mjaltë në lulet e qershisë. Kur u kthye në zgjua, e peshoi nektarin dhe pa se kishte mbledhur 30 gramë. Në çdo lule ajo mbledhi 1 gram e gjysmë. Gjeni sa lule qershie ka mbledhur nektar bleta punëtore?”

Klasa heshti.

– E kuptova problemin?

– O të kuptuar, përnjëherë, – fërkoi duart Tipi. – Unë gjithmonë i kam kuptuar shpejt problemet me mjaltë.

– Të lumtë! Ç’veprim do bëjmë për të gjethur atë që kërkon problemi?

– Shumëzim, – ia këputi tërë gëzim Tipi. Në klasë u dëgjuan të qeshura.

– Ju punoni pa zë – i qortoi mësuesja dhe pastaj u kthye përsëri nga arushi. Mendohu, mendohu mirë.

Po ku mendonte dot arushi! Në kokën e tij zunë të lëvrinin disa miza të mërzitshme. “Mësuese Mjellma më ka marrë inat. Gjithmonë mua më zgjedh problemet më të vështira. Pa ç’fat i keq! Pikërisht sot, që nuk isha përgatitur, më ngriti mua.

Ç’fat që ka Çufoja, ai është më tapë se unë, por ja që shpëtoi”.

Tipi nisi të shkarraviste diçka me shkumës, kur në derën e klasës u dëgjuan përsëri të trokitura. Ai ngriti veshët. Në klasë hyri drejtoresha e shkollës “Rrezet e arta” dhe dy pëllumbesha infermiere të veshura me bluza të bardha akull fare. Nxënësit u ngritën në këmbë.

– Na fal, mësuese Mjellmë, – i tha drejtoresha, – por tani erdhën këto shoqet për t’u bërë vaksinat e lisë nxënësve.

– Urdhëroni! – i ftoi Mjellma. Pastaj iu kthye arushit. – Ti ulu. Ditën e parë që të kemi aritmetikë, do të ngre përsëri.

Arushi nuk priti më, la shkumësin dhe nxënësit përveshen mëngët... Vetëm lepurit deshi të dilte nga dritarja, por vështrimi qortues i drejtoreshës e mbërtheu për një çast në vend ...pastaj ai u fut nën tryezën e mësueses, po edhe aty e zbuluan...

Po t’u qepën, edhe në kavanoz të reçelit të gjejnë! Lepur, përveshi mëngët!

Nexhati Tafa

LEPURUSHI NUK KA GJUMË

Lepurushi në dritare,
Është i trembur, s’ka gjumë fare.
Dhelpra qesh dhe e ngacmon,
Ujku dhëmbët i tregon.
Por arushi babaxhan,
I afrohet aty pranë.
Mos ki frikë, ti lepurush,
Luajmë bashkë, s’të prek kush.

LOPA, DHIA DHE DELJA

Të mos jenë,
Ato të tria,
Qumësht, kos
Nuk ka shtëpia
Një bën “mu”,
Tjetra “me”,
Dhe e treta “be, be, be”,
Cilat janë,
A i njeh?

Xhahid Bushati
KAÇUBA E IRIQIT

Ishte një iriq i vogël. Sigurisht me gjemba. Jetonte në një kaçubë, larg pyllit. Një ditë, iriqi u nis për udhë. E eci e eci dhe hyri në pyll.

- Pse nuk vjen të jetosh në pyll? – e pyetën ca fletë të gjelbra.
- Po unë kam lindur në kaçubë.
- Qenke i zgjuar, o iriq, – i thanë fletëzat e gjelbra.
- Faleminderit, – u përgjigj iriqi.

Ninullë
NINANANA

Kur nis shiu nxihen retë,
Bu e bu zbresin rrëketë,
Njomën fushat, njomën drurët,
Lagën njerëzit, lagën gurët.

Fryhet lumi kur zë shiu,
Pemët nis e rreh veriu,
Në kafaz futet pëllumbi,
Vogëlushët i zë gjumi.

Sepse shiu që pikon,
Nina-nana u këndon.

Dritëro Agolli
EDUKATA

Dy macka qimebardha porsi shkumës,
në pjatë hanin tok përshesh me qumësht.

Dy qentë shikonin vëngër të mërëzitur,
dhe kuvendonin, veshët duke ngritur.

– Këto nuk paskan fare edukatë,
e sheh si futin hundët në një pjatë?

Ndërkohë u ra një kockë mu në këmbë,
për kockën qentë u shqyen keq me dhëmbë.

U ngrit një zhurmë e madhe e shamatë,
dhe macet thanë: “Kjo është edukatë!”

Tahsim Gjokutaj
FAMILJA

Mami, babi edhe motra,
gjyshi, gjyshja dhe vëllai,
jetojnë në një shtëpi,
plot gëzim e lumturi.

Flasin, qeshin dhe punojnë,
njëri-tjetrin e ndihmojnë.
Që të gjithë një mendje kanë,
një familje ata janë.

këngë për fëmijë-popullore

SJELLJA E MIRË

Kurrë mos harroni
Me mirësi njerëzit t’i trajtoni,
Sepse kush dhuron dashuri,
është më i shtrenjtë se çdo njeri.

KËSULËKUQJA

(Ritreguar sipas përrallës origjinale të Sharl Perrolt)

Na ishte njëherë një vajzë e vogël, që jetonte në mes të një pylli të dendur bashkë me nënën dhe babanë e saj, i cili ishte druvar. Vajza e vogël mbante përherë të veshur një mantel të kuq me një kapuç të ngrohtë të kuq dhe nga kjo, e thërrisnin Kësulëkuqe.

Një ditë ajo vendosi të shkonte për vizitë te gjyshja e saj, që jetonte paksa larg kasolles së druvarit. Vajza mori shportën, në të cilën nëna kishte vënë një kek, që e kishte pjekur për gjyshen, dhe u nis. Kur u ndanë, nëna i tha Kësulëkuqes së vogël: “Ec vetëm drejt rrugës dhe mos u fol të panjohurve”, por ka të ngjarë që Kësulëkuqja të mos i ketë dëgjuar këto fjalë. Sepse, kur pa disa zymbyla të kaltër nën një pemë, ajo u largua nga rruga dhe filloi të mblidhte lule që t’ia çonte gjyshes. Pak nga pak, duke u futur më thellë mes drurëve të pyllit, vogëlushja u largua shumë nga rruga. Papritur ajo pa se nuk ishte vetëm. Përpara saj qëndronte një ujk i madh dhe i fuqishëm. Kësulëkuqja e vogël s’kishte parë kurrë ujk, andaj nuk e dinte se me ujqit s’duhet të sillesh e të flasësh kurrë miqësisht.

– Mirëdita, vogëlushe, – i tha ujku duke skërmitur dhëmbët me njëfarë buzagazi të shpifur.

– Si të quajnë dhe ku po shkon?

– Më quajnë Kësulëkuqe, – tha vogëlushja. Po shkoj te gjyshja dhe po çoj një kek, – iu përgjigj ajo.

Ujku u gëzua. Jo vetëm që do të hante një vajzë të vogël, por edhe gjyshen e saj bashkë me gjithë kekun.

Dhe, ku banon gjyshja jote vogëlushe? – e pyeti ujku, duke u përpjekur shumë ta mbante buzëqeshjen në fytyrë, pavarësisht nga dhëmbët e frikshëm që kishte.

Kësulëkuqja Vogëlushe i tregoi ujkut se ku banonte gjyshja dhe vazhdoi të mblidhte zymbylat. Ujku u zhduk përtej pemëve dhe shpejt e gjeti kasollen e gjyshes. Ai trokiti në derë dhe tha më një zë të ndryshuar:

– Mirëdita gjyshe, jam Kësulëkuqja dhe të kam sjellë një kek. Hapma derën, të lutem.

Sapo u hap dera, ujku kërceu brenda dhe e kullufiti gjyshen krejt! Pastaj vuri në kokë skufjen e saj të natës, u mbështoll me shallin e gjyshes dhe u shtri në shtratin e saj. Pas pak ia mbërriti kësulëkuqja dhe ujku u përpoq përsëri të mbante në fytyrë buzagazin e tij, pavarësisht nga dhëmbët e tij të mprehtë.

– Mirëdita, gjyshe, – tha Kësulëkuqja e vogël. – Të solla një kek dhe këta zymbyla, – dhe iu afrua shtratit.

– O Zot! Gjyshe ç’i ke ata sy kaq të mëdhenj? – u tmerrua ajo.

– Që të të shoh ty sa më mirë, – hungëriti ujku.

Ndërkohë, Kësulëkuqja e vogël shqeu sytë, kur pa dhëmbët e ujkut.

– O Zot! Gjyshe ç’i ke ata dhëmbë aq të mëdhenj?

– Që të të ha ty! – foli ujku më zë të trashë dhe, sa hap e mbyll sytë, e kullufiti Kësulëkuqen. Pastaj kullufiti edhe shportën me gjithë ëmbëlsirë, dhe ashtu me barkun të fryrë sa një daulle, ia këputi me gjumë, duke gërritur.

Për fat të mirë para kasolles, po kalonte babai i Kësulëkuqes. Ai dëgjoi gërritjen e tmerrshme të ujkut. U kthye menjëherë dhe u fut brenda kasolles, për të parë se kush e bënte gjithë atë zhurmë. U tmerrua kur pa ujkun, ndaj rrëmbeu sëpatën dhe, më një të rënë, ia çau barkun ujkut. Nga barku i çarë, në fillim doli Kësulëkuqja, pastaj gjyshja. Kjo ia qepi ujkut të çarën dhe i tha që në të ardhmen të sillej mirë. Meqenëse tani s’kishte më kek për të ngrenë në vaktin e çajit, të gjithë vajtën në shtëpinë e Kësulëkuqes. Nëna e saj bëri petulla. Kam kënaqësinë të them se Kësulëkuqja mori një mësim të mirë dhe nuk foli më kurrë me ujkun.

PRINCESHA ME BIZELE

(Princesha dhe kokrra e bizeles. *Ritreguar sipas përrallës origjinale të Hans Kristian Andersenit*)

Princi ishte shumë i mërzhitur. Të gjithë në oborrin mbretëror, duke filluar nga i ati, mbreti deri te pazhi më i vogël, dukeshin sikur i thoshin se kishte ardhur koha të martohej. Ç'është e vërteta, princi do të kishte qenë shumë i lumtur, nëse do të martohej, por ai ngulte këmbë që nusja e tij të ishte princeshë e vërtetë, prej dere fisnike. Ai kishte udhëtuar nëpër mbretëri dhe kishte ndeshur shumë plot vajza të bukura, që thoshin se ishin princesha, mirëpo atij i ishte dukur se asnjëra prej tyre s'kishte qenë princeshë e vërtetë prej dere fisnike.

As sjelljet e tyre s'i qenë dukur fort të hijshme, kurse këmbët e tyre i qenë dukur tepër të mëdha. Kështu që princi rrinte i mbyllur në pallat, duke lexuar libra të vjetër e të pluhurosur historie dhe duke u bërë përditë e më i zymtë.

Një natë bëri një stuhi jashtëzakonisht e fortë. Shiu binte më rrëshkë, vetëtimat e bënin e bënin dritë vendin përreth dhe gjësimet tundnin muret dhe dritaret e pallatit. Era shuante qirinjtë dhe të gjithë strukeshin sa më pranë zjarrit. Befas u dëgjua tingëllima e fortë e ziles gjigante të portës së pallatit. Kur u hap porta, u shfaq një vajzë e lagur nga koka te këmbët. Ajo tha se qenkej princeshë, por s'kishte njeri në botë që ta merrte atë për një princeshë, sepse vetëm me një princeshë ajo nuk ngjante. Flokët i qenë ngjitur në kokë, fustani i lagur që rru-dhosur e ngjitur pas trupit, kurse këpucët i qenë bërë gjithë baltë. Pasta, ishte fare vetëm, pa një shërbëtore, qoftë edhe të rëndomtë. Megjithatë ajo ngulte këmbë se na qenkej princeshë. Mirë, xhanëm, po nga vinte, vallë, kjo farë princeshe? "Do ta këqyrim këtë punë", tha me vete mbretëresha dhe urdhëroi ta fusin brenda... ndërsa vajzën e bërë qull nga shiu e ulën pranë zjarrit dhe i dhanë një tas qumësht të ngrohtë me mjaltë për ta pirë, mbretëresha shkoi në dhomën e mysafirëve, që ishte e dyta në pallat për nga komoditeti, për të kontrolluar si që rregulluar shtrati. Aty ajo mendoi se ç' mund ta vinte vizitoren e ardhur natën vonë në atë shtrat të mirë, që ishte vetëm për mysafirët e nderuar.. kurse, vajza e nderuar, nuk ishte e tillë, tek e fundit, ajo mund të ishte një dukeshë e rëndomtë. Prandaj mbretëresha u tha shërbëtoreve të hiqnin nga shtrati të gjitha shtrojat, kuvertën, jorganët, çarçafët, madje, edhe dyshekun. Pasi shtrati u boshatis, ajo urdhëroi që në mes të tij të vinin një kokërr bizele dhe mbi të të vinin, njëri mbi tjetrin, njëzet dyshekë dhe mbi dyshekë njëzet jorganë me pupla. Pasi i rregulluan mirë e mirë, siç u tha mbretëresha, shërbëtoret e morën mysafiren, që tani ishte terur e ngrohur, dhe e çuan në atë dhomë, për të fjetur.

Në mëngjes, mbretëresha, e veshur me rrobën e shtëpisë, hyri në dhomën e gjumit të mysafirëve dhe e pyeti vajzën si kishte fjetur.

– S'vura gjumë në sy gjithë natën, – tha ajo.

– Në mes të shtratit ishte një gungë e madhe dhe e fortë. Më zuri frika, pale që e kam trupin gjithë plagë!

Pas këtyre fjalëve, të gjithë në pallat besuan se vajza duhej të ishte princeshë, se vetëm një princeshë e vërtetë mund ta kishte lëkurën aq të ndjeshme. Princi u gëzua dhe kërkoi me ngulm të martohej menjëherë me të dhe prej asaj kohe, çifti jeton i lumtur. Ata flenë përherë në shtretër shumë të butë, kurse kokrrën e bizeles e çuan në muze, ku, ndoshta, është edhe sot e kësaj dite.

BORËBARDHA DHE SHTATË XHUXHËT

(Ritreguar sipas përrallës origjinale të vëllezërve Grim)

Mbretëresha shtatzënë rrinte te dritarja, duke qepur e duke menduar për foshnjën që do të lindte së shpejti. Teksa qepte shpoi gishtin me gjilpërë dhe nëpër parvazin prej dru abanozi të dritares rrodhi një pikë gjaku, që ra në dëborë.

– Dëshiroj që foshnja ime të jetë e bardhë si bora, e zezë si abanozi dhe e kuqe si gjaku, – tha ajo me vete. Dhe kështu ndodhi. Ajo lindi vajzë dhe vogëlushja e kishte me të vërtetë lëkurën e bardhë si bora, buzët e kuqe si gjaku dhe flokët e zezë si abanoz, ndaj mbretëresha e quajti vajzën Borëbardhë. Por mbretëresha vdiq dhe mbreti u martua përsëri. Gruaja e tij e re ishte e bukur, por shumë zemërkeqe dhe nuk e donte Borëbardhën.

Çdo mëngjes mbretëresha e re shihej në pasqyrën e saj magjike dhe pyeste: Pasqyrë, moj pasqyrë në mur!

Në trevën tonë cila është më e bukur, plot nur? Dhe pasqyra gjithnjë i përgjigjej:

Oh, padyshim, ju, o mbretëreshë, ju, Ju jeni më e bukura këtu.

Dhe mbretëresha kënaqej. Kaluan shtatë vjet dhe Borëbardha u rrit dhe u bë një vajzë e hijshme. Ajo kishte natyrën e ëmbël të së ëmës.

Një mëngjes, mbretëresha u pa në pasqyrë dhe pyeti si zakonisht, por këtë herë përgjigja e pasqyrës nuk e kënaqi, përkundrazi, e mbushi me zemërim dhe me smirë:

Ju, vërtetë, jeni e bukur, madhëri, por Borëbardhës s'i afrohet kush për bukuri. Mbretëresha u zemërua shumë dhe menjëherë urdhëroi druvarin e pallatit ta vriste Borëbardhën. Dhe u nis druvari ta gjente Borëbardhën, por atij s'i bënte zemra ta bënte këtë vepër kaq të ligë. Ai e nxori Borëbardhën nga shtëpia, e futi thellë në pyll dhe e la aty pa i bërë asgjë. E shkreta Borëbardhë, gjithë ditën u soll vërdallë nëpër pyll, pa e gjetur dot rrugën për në shtëpi dhe, kur u bë natë, ishte krejt e rraskapitur dhe e frikësuar.

Papritmas, asaj i zunë sytë një dritë, që vinte përmes pemëve nga diku larg. Borëbardha nisi të ecte në atë drejtim dhe, pas pak, pa një kasolle me një dritare të vogël, ku ishte një fener i ndezur. Vajza hyri brenda.

Gjithçka në atë shtëpi ishte akull e pastër. Në mes të dhomës ishte një tryezë dhogash që ndrinte nga pastërtia dhe mbi të ishin vënë shtatë pjata dhe shtete tasa. Rreth oxhakut ishin të renditura shtatë karrige të vogla, ndërsa përgjatë murit shtatë shtretër të vegjël, secili i mbuluar me një batanije në ngjyrë të ndritshme.

Pranë zjarrit ishte një kanistër me dru zjarri. Borëbardha vajti te oxhaku dhe ndezi shpejt e shpejt një zjarr bubulak. Pastaj u ul në njërin nga karriget e vogla dhe aty e zuri gjumi.

Kjo kasolle na ishte shtëpi e shtatë xhuxhëve. Në mbrëmje xhuxhët u kthyen në shtëpi dhe u habitën shumë kur panë një vajzë të panjohur, që flinte e qetë mbi një karrige. Por nuk e zgjuan. Ata nuk folën asnjë fjalë dhe ecnin nëpër dhomë në majë të gishtave, që të mos e zgjojnë mysafirin. Në heshtje ata filluan të përgatisin darkën dhe kur aroma e këndshme e supës mbushi dhomën, Borëbardha fërgëlloi një herë dhe u zgjua. Tani ishte ajo që mbeti shumë e habitur, kur pa shtatë fytyra të vogla, të cilat e shihnin tërë ëmbëlsi. Pasi fërkoi sytë, ajo u buzëqeshi të zotëve të shtëpisë dhe menjëherë nisi t'u tregonte sesi kishte ardhur aty. Ata u zemëruan shumë, kur dëgjuan për mbretëreshën e keqe.

– A mund të rri tek ju? – i pyeti Borëbardha. – Unë do t'ju shërbej dhe ju do ta keni supën gati çdo natë.

Xhuxhëve u pëlqeu shumë ky propozim dhe të gjithë ia nisën punës për t'i bërë Borëbardhës një karrige, për të ndenjur pranë zjarrit, dhe një krevat për të fjetur.

Të nesërmen në mëngjes, atje në kështjellë, mbretëresha u pa përsëri në pasqyrën e saj dhe e pyeti:

“Pasqyrë, moj pasqyrë në mur, në trevën tonë kush është më e bukur, plot nur?”

Mund ta përfytyroni tërbimin e saj, kur pasqyra iu përgjigj: “Ju, vërtetë, jeni e bukur, madhëri, por Borëbardha që te shtatë xhuxhët banon, është më e bukura në trevën tonë”.

E bërë pikë e vrer, mbretëresha u maskua si një plakë që shiste çikërrima dhe shkoi të kërkonte kasollen e xhuxhëve. Më në fund, e gjeti dhe, pa vonuar, trokiti në portë. Borëbardha se njohu që ajo ishte mbretëresha dhe ftoi brenda.

– O zot i madh, fustani juaj ka nevojë për lidhëse të reja, – tha plaka dhe menjëherë nxori nga thesi një palë lidhëse, ia vuri vajzës në fustanin që mbante veshur dhe ia shtrëngoi aq fort sa Borëbardha s’mbushej dot me frymë.

Xhuxhët u kthyen në shtëpi dhe u tmerruan kur panë Borëbardhën të shtrirë në dysHEME si e vdekur. Ata e ngritën dhe menjëherë u ranë në sy lidhëset e reja. I prenë shpejt e shpejt ato dhe menjëherë Borëbardha erdhi në vete. Asaj iu kthye sërish ngjyra normale e fytyrës. Ajo u tregoi gjithë sa kishte ndodhur.

– Ti e di që mbretëreshën s’ka gjë që e ndal të të bëj keq, – e qortuan xhuxhët Borëbardhën. – Ndaj s’duhet t’ia hapësh derën askujt.

Të nesërmen në mëngjes mbretëresha u pa serish në pasqyrë dhe u tërbua nga inati, kur pasqyra i tha prapë se Borëbardha ishte më e bukura në mbarë trevën. Ajo u maskua serish dhe u bë si një cigane, që shiste kapëse rrobash, krehra, pasqyra etj., dhe vajti te shtëpia e xhuxhëve. Kur trokiti në derë, Borëbardhës iu kujtua se çfarë i kishin thënë xhuxhët, ndaj nuk ia hapi derën ciganes. Atëherë cigania vajti te dritarja dhe futi që andej një krehër. Borëbardha e pa, e mori dhe sapo krehri preku flokët e saj, ajo ra në dysHEME pa ndjenja. Krehri kishte qenë i lyer me helm.

Kur xhuxhët u kthyen në shtëpi e gjetën përsëri Borëbardhën të shtrirë. Menjëherë dysHuan se prapë kishte gisht mbretëresha. Në flokët e Borëbardhës ata gjetën një krehër. sapo ia hoqën vajzës nga koka, ajo u ngrit në këmbë dhe ndihej fare mirë. Xhuxhët u gëzuan pa masë dhe iu lutën që ditën tjetër, meqë ata do të shkonin në punë, ajo të tregohej më e kujdesshme.

Edhe të nesërmen Borëbardha dëgjoi të trokitura në derë. Ajo pa nga të çarat e dërrasave të derës së shtëpisë një grua fshatare, që tha se shiste mollë. Kuptohet, vajza nuk ia hapi derën, as dritaren.

– E kuptoj, të gjithë dyshojnë për mua, por unë nuk bëj asgjë të keqe, – foli fshatarja, që sigurisht nuk ishte shitëse mollësh, por mbretëresha e ligë e maskuar. – Unë thjeshtë dua të të jap disa mollë. Shiko sa të lëngshme janë! – tha ajo dhe këputi një kafshatë të madhe nga një kokërr mollë dhe i zgjati Borëbardhës një mollë tjetër.

Borëbardha, si e padjallëzuar që ishte, mendoi se fshatarja s’ia kishte me të keq, ndaj e mori kokrrën e mollës, që i zgjati ajo nga dritarja. Por mbretëresha e kishte lyer edhe atë me helm, si krehrin, dhe sapo Borëbardha e kafshoi, ra në dysHEME e vdekur.

Këtë herë kur xhuxhët u kthyen në shtëpi, s’mund të bënë asgjë, pasi Borëbardha kishte vdekur vërtetë. Kur u bindën për këtë, atyre s’u bënte zemra ta varrosnin në dheun e ftohtë.

Ndaj e vranë dhe e vranë mendjen dhe, më në fund e vunë Borëbardhën në një arkëmort prej qelqi, që ta shihnin përherë. Në njërën anë të arkëmortit shkruan me shkronja argjendi emrin e saj dhe pastaj e çuan në pyll, ku ndërtuan një strehë me çati, rreth e përçark së cilës mbollën lule të bukura.

Të nesërmen në mëngjes, kur mbretëresha u pa në pasqyrë, mori përgjigjën që dëshironte. Ju, o mbretëreshë dhe vetëm ju, jeni më e bukur këtu.

Kaluan vite. Borëbardha qëndronte të rrinte e shtrirë në arkëmortin e saj prej qelqi, ku dukej po aq e bukur, sa ç’kishte qenë kur ishte gjallë. Xhuxhët e ruanin vazhdimisht. Një ditë ata panë një princ të ri që u përkul mbi arkëmortin e Borëbardhës dhe nisi të qante. Ai kishte rënë në dashuri më të që në çastin që e kishte parë, kur ajo ishte gjallë. Kur xhuxhët panë se sa shumë e donte princi Borëbardhën e tyre të dashur e pranuan kërkesën që u bëri ai që ta çonin arkëmortin prej qelqi në pallatin e tij. Ai kishte vendosur ta mbante në kopshtin e vet plot trëndafila.

Kur princi e ngriti arkëmortin prej qelqi, nga lëvizja, pjesa e helmit të mollës ra nga buzët e Borëbardhës. Papritur ajo hapi sytë, pa princin, pastaj vështroi edhe xhuxhët e saj besnikë dhe pyeti:

– Ku jam? Ç’më ka ndodhur?

Kur xhuxhët panë që Borëbardha hapi sytë dhe foli, i pushtoi të gjithë një ngazëllim i madh; flisnin të gjithë përnjëherësh dhe brohorisnin dhe kërcenin përpjetë nga gëzimi. Princi i mrekulluar nga ringjallja e Borëbardhës, me ta nxjerrë nga arkivoli, nxitoi t’i kërkonte të martohej me të. Ajo pranoi por me kusht që bashkë me të të vinin të jetonin në pallat edhe xhuxhët. Princi nuk kundërshtoi dhe që nga ajo ditë të gjithë jetuan të lumtur.

Po me mbretëreshën ç’ndodhi? Pikërisht atë mëngjes kur Borëbardha dhe princi do të martohej, ajo shkoi të shihej në pasqyrën e saj.

Pasqyrë, moj pasqyrë, në mur,

Në trevën tonë cila është më e bukur, plot nur? Pasqyra iu përgjigj ndryshe nga ditë të tjera:

Borëbardha është më e bukur pa dyshim, Nga bukuria ajo me asnjë nuk krahasohet, Dhe sot me princin do të martohet.

Sa dëgjoji këto fjalë, mbretëresha u tërbua fare, u nxi në fytyrë dhe u shëmtua edhe më keq, sa që pasqyra krisi dhe u thye copa-copa. Dhe deri në fund të jetë së saj mbretëresha nuk u pa më në pasqyrë.

Fabul

MIU DHE ELEFANTI

Një ditë, një mi hipi mbi shpinën e një elefanti dhe filloi të mburrej se ishte më trim se një elefant. Elefanti babaxhan e dëgjonte qetësisht dhe nuk fliste fare.

Ec e ec..

– Ku po shkojmë kështu? – u përmend dhe pyeti miu i habitur.

– Më ka ftuar miku im, maçoku, – i tha elefanti. – Dua t’i tregoi një mi trim.

Miu u hodh nga kurrizi i elefantit dhe ia mbathi me të katërta.

Vëllezërit Grim

UJKU DHE SHTATË KECAT

Njëherë në një kohë jetonte në pyll, në një shtëpizë prej druri, një dhi me shtatë kecat e saj çamarrokë. Një ditë mëma dhi duhej të çonte pak ushqim te një kushërira e saj e sëmurë. Nuk donte të linte kecat e saj vetëm, sepse kishte frikë nga ujku i keq që sillej vërdallë në pyll. “Do të kthehem shpejt” – u tha. “Mos ia hapni derën askujt. Kuptuat?” “Po mami” – u përgjigjën kecat. “Mund të ikësh e qetë”.

Por ujku, që ishte i fshehur prapa një peme, e pa dhinë që iku. Doli nga vendi ku ishte fshehur dhe vajti tek shtëpiza.

Trokiti në portë. “Kush është” – pyetën kecat e vegjël. “Jam mamaja juaj. Harrova diçka” – duke e bërë zërin sa më të hollë që mundej. “Thua gënjeshtër! Mami jonë nuk e ka zërin kështu” – tha keci më i madh.

Ujku iku i zemëruar. Hëngri disa vezë dhe mjaltë dhe zëri iu hollua. “Këtë herë do t’ua hedh” – mendoi i kënaqur.

Sapo dëgjuan zërin e tij, për pak sa nuk e hapën portën, por në çastin e fundit nguruan. “Na trego këmbën poshtë portës” – thërritën kecat.

“E marrtë dreqi e marrtë! Prapë më kuptuan!” – mendoi ujku i shkalluar nga inati e u drejtua për në mulli.

Arriti atje, futi këmbën brenda në një thes me miell dhe, kur e nxori, ishte aq e bardhë, sa për pak nuk e njohu as vetë. Pastaj u nis përsëri për në shtëpizën ku rrinin kecat.

Trokiti përsëri në derë dhe u tha kecase të hapin portën. Kecat i kërkuan ta tregojë këmbën e tij. Ujku nuk ngurroi dhe ua tregoi. E futi në të çarat e portës. Këmbe më të vërtetë tashti ishte e bardhë. Kecat u mashtruan dhe e hapën portën.

Kur ujku hyri brenda, nuk dinte se cilin kec të hante më përpara. Ishin të gjithë buçko dhe sigurisht shumë të shijshëm! Kecat luftuan që të shpëtonin, por ujku ishte i fortë dhe i gëlltiti të gjithë.

I kënaqur dhe i ngopur u nis për në pyll. Gjeti një strehim dhe u shtri të flejë.

Kur mama dhia po i afrohej shtëpizës së vet, u çudit që nuk po dëgjonte zërat e fëmijëve të saj. Kur hyri dhe pa rrëmujën, mendoi: “Tani e kuptova. I bënë lëmsh të gjitha dhe nga frika se mos bërtas u fshehën.” Por pasi kërkoi dhe nuk i gjeti, dyshoi se kishte ndodhur diçka e keqe, diçka e tmerrshme.

E tmerruar vrapoi në pyll të kërkonte ndihmë. Ishte e dëshpëruar. Nuk dinte ç’të bënte. Pa pritur dëgjoi dikë që këndonte. Ishte druvari. Dhia iu afrua dhe i foli për dyshimet e saj.

Ai ishte i gatshëm ta ndihmonte. Rrëmbeu sëpatën dhe u drejtua andej nga ishin gjurmët e ujkut. Në një vend të hapur të pyllit panë ujkun që po flinte. Druvari hapi menjëherë barkun e ujkut me sëpatë dhe nxori jashtë të gjallë të shtatë kecat. Pastaj futi në barkun e tij gurë të mëdhenj dhe e qepi.

Kur ujku u zgjua, kishte etje të madhe. Hapi gojën dhe u nis dalëngadalë drejt lumit. “Hënga sa gati plasa” – mendoi. Kur arriti te lumi, u përkul për të pirë ujë, por pesha e gurëve bënë që të binte brenda.

Të shtatë kecat e vegjël filluan të hidhen përpjetë nga gëzimi. Ftuan druvarin në shtëpizën e tyre dhe i rrëfyn se si kishte ndodhur. Që të mos ndodhte përsëri një gjë e tillë dhe për të mos u mashtruar kurrë më, vendosën tek porta një sy magjik për të parë vizitorët e tyre.

Ata jetuan të lumtur dhe ne akoma më mirë.

Virgjl Muçi - përrallë për fëmijë

KATËR SHOKËT

Një fshatar kishte një gomar. Me gomarin i kishte bërë ballë mundimeve të jetës. Me gomarin ngarkuar shkonte në qytet e kthehej nga qyteti. Me gomarin shkonte në pyll, në arë, në mulli për të bluar drithin, shkonte pra kudo. Gomari ishte bërë pjesë e jetës së tij. Por koha bëri të sajën. Gomari i mjerë u plak. Një ditë gjunjët nuk e mbajtën dhe u rrëzua për dhe. Fshatari e largoi nga shtëpia. Gomari mori udhët....Ec e ec... Rrugës takoi një qen plak. Një jetë të tërë qeni i kishte shërbyer me besnikëri të zot, por kishte ardhur pleqëria dhe i zoti e kishte larguar nga shtëpia.

– Eja me mua, – i tha gomari, – shkojmë dhe kërkojmë fatin tonë.

– Unë nuk eci dot, – tha qeni, – nuk më mbajnë këmbët.

Gomari u mendua një çast, pastaj e mori qenin në kurriz. E kështu vazhduan rrugën bashkë.

Ec e ec e rrugës takuan një maçok plak. Nuk e kishin të vështirë ta merrnin me mend se edhe atë e kishin larguar nga shtëpia. Dikur minjtë tmerroheshin prej tij, por me kalimin e viteve sytë, veshët dhe këmbët, e kishin lënë. Të zotëve të shtëpisë nuk u vlente më dhe ai nuk e dinte se ç’fat e priste.

– Eja me ne dhe kërko fatin tënd, – i tha gomari.

U mendua dhe u mendua maçoku dhe atëherë kur gomari dhe qeni po bëheshin gati për udhë, i ndoqi pas.

Ec e ec dhe arritën pranë një gardhi. Mbi gardh lebetitej një gjel i madh dhe i bukur. E pyetën ç'hall kishte dhe gjeli u tha se zonja e shtëpisë do t'i këpuste kokën për të gostitur ca mysafirë që kishin ardhur në shtëpi.

– Eja me ne dhe kërko fatin tënd, – i tha gomari.

Gjeli nuk u mendua aspak, por u hodh nga gardhi e u bashkua edhe ai me shokët e mjerimit. Dhe u nisën për udhë...Gomari printe përpara; qeni ecte pas gomarit, maçoku pas qenit dhe gjeli pas maçokut.

Ec e ec dhe i zuri nata buzë një pylli të dendur.

– Qëndrojmë këtu sonte e nesër vazhdojmë udhën, – tha gomari.

Dhe ashtu bënë. Gomari u shtri pranë trungut të një druri; qeni u mbështet në kurrizin e tij, ndërsa maçoku ndoqi gjelin në degët e drurit. Atje lart, gjeli dalloi, dritën e një shtëpie.

– Të shkojmë atje, – tha gomari.

U nisën përsëri në udhë. Qeni pas gomarit, maçoku pas qenit, gjeli pas maçokut e më në fund arritën tek shtëpia me dritë në fund të pyllit.

Gomari u afrua i pari tek dritarja dhe nuk po lëvizte së andejmi.

Qeni, maçoku e gjeli e pyetën gomarin se çfarë shikonte aty brenda. Gomari u tha se shikonte një sofër të shtruar dhe rreth e qark saj një grup kusarësh. Katër shokët e mjerimit nuk kishin se çfarë të prisnin më. Qeni kërceu në kurriz të gomarit; maçoku kërceu mbi kurriz të qenit dhe gjeli mbi kurrizin e maçokut. Gomari pëlliti; qeni lehu; maçoku mjaulliti dhe gjeli ia dha kikërimës.

Ishin katër muzikantët më të veçantë të botës. Kusarët u tmerruan dhe ia mbathën nga sytë këmbët.

Të katër miqtë, u shtruan rreth sofrës për katër palë qejfe. U lodhën së ngrëni dhe kur nuk kishin më forca për të ngrënë, shuan dritat e u shtrinë të flinin si princër.

Kusarët kishin qëndruar diku larg, përtej pyllit. Nuk mbusheshin dot me frymë edhe pse kishte kaluar një kohë e gjatë që nga çasti i shfaqjes së përbindëshave.

Kryekusari, urdhëroi njërin nga kusarët të shikonte se ç'bëhëj në shtëpinë e tyre.

Kusari hyri në shtëpi, por atje ishte errësirë e madhe. Ai ndezi shkrepësen. Flaka e shkrepëses lëshoi një ndriçim verbues para syve të maçokut. Maçoku i trembur kërceu nga vendi dhe e gërvishti kusarin me thonj në fytyrë. Kusari nuk e kuptoi ç'ndodhi dhe ia dha vrapit për të dalë nga dhoma. Në errësirë, ai shkeli mbi qenin. Qeni iu hodh për ta shqyer. Kusari u rrokullis dhe u godit me shkelma nga gomari. Gjeli nuk mund të mbetej prapa shokëve dhe e goditi me sqep.

Kusari u bind se në atë shtëpi ishin futur përbindësja. Kur dëgjjuan rrëfimin e tij, kusarët e tjerë u larguan duke vrapuar e nuk e kthyen më kokën prapa.

VJESHTA

Vjeshtë e artë a s'më thua,
Çfarë dhuratash më sjell mua?
Vjeshta qesh edhe më thotë:
– Të kam sjell dhurata plot.
Hapi duart vogëlush,
Plot me fruta di t'i mbush,
Mollë, dardhë, ftonj e rrush.

VITI I RI

I bardhë nëpër borë,
Vjen Vit i Ri,
Mbushur e ka këngën,
Plot me dashuri.

Por askënd në botë,
Nuk e kapërcen,
Edhe ndalet pakëz,
Dhe zemrën ta gjën.

Botën tonë atëherë,
E gëzon kjo stinë,
Dhe na duket toka,
Si një balerinë.

Edhe viti i vjetër,
Kujtimet i nis,
E shtigjeve të kohës
Historinë qëndis.

DITË DIMRI

Dhe të dua dhe s'të dua,
Ti, o dimër, fol me mua,
Sjell tufanin dhe stuhinë,
Thyen pemët, tremb bagëtinë.

Mik me zjarrin, mik me borën,
Pa doreza ma ngrinë dorën,
Pallto e kapuç me push,
S'kemi frikë nga askush.

Luajmë, qeshim zënë për dore,
Bëjmë plakun prej dëbore.
Je i ashpër, je i mbarë,
Por ne jemi guximtarë.

Adelina Mamaqi

FESTA JOTE, FESTA IME

Mamin për tetë mars,
Fort e puttha unë,
Dhe në vesh i thashë:
"Qofsh e lumtur shumë".

Kur ti je e lumtur,
Ndiej dhe unë gëzime:
Festa jote e bukur
Është dhe festa ime.

NJË QERSHORI

Gonxhe çelin sot zambakët,
Se kanë festën vocërrakët.
Eja, eja shoku im,
Na pret fusha plot gëzim.
Erdha, erdha shpejt,
Porsi zogu krahëlehtë.
Le të mbledhim lule plot,
Një Qershorin kemi sot.

III TEKSTE SHITESË

DHELPRA

Dhelpra vjedhacake,
udhës kaloj,
oborrit iu afrua,
pulat kërkoi.

Kur lehu qeni,
bishtin dredhi,
iku përsëri,
udhës kah erdhi.

KUR BUZËQESH NËNA IME

Kur buzëqeshë
nëna Nushë:
sa shumë lule
çelin në fushë!

Kur këndon
nëna ime,
i ngjan burimit
me gurgullime.

Kur m'përkëdhel
Nëna me dorë
Diçka ma ngroh
Zemrën n'kraharror.

E dini ç'është
nëna ime?
është dritë
e jetës time.

GIMI U LAG

Pata bën ga, ga, ga
Kërkon bibat ku i ka
Rosa bën mak, mak, mak
Rosë e vogël eja pak.

Patat, rosat u larguan
Në ujë lumi u freskuan
Ga, ga, ga e mak, mak, mak
Gimi i vogël pse u lag?

Fabul popullore

TRI DHITË DHE UJKU

Gjyshja i tregoi Gjergjit:

– Tri dhi kullotnin në pyll. Dhia e vogël u nis e para. Udhës takoi ujkun.

– A po ik, a po të ha? – pyeti ujku. Ajo u përgjigj:

– Mos më ha, or ujk. Do të vijë dhia më e madhe. Më të do të ngihesh më mirë.

Pastaj arriti dhia më e madhe. Ujku e pyeti:

– A po ik, a po të ha?

– Mos më ha, or ujk. Do të vijë dhia edhe më e madhe. Më të do të ngihesh edhe më së miri.

Pastaj erdhi dhia edhe më e madhe. Ujku deshi ta hajë. Dhitë i dhanë me brirë e ujku u rrokullis në lumë.

Fabul nga Ezopi

LEPURI DHE IRIQI

Ka qenë një kohë kur lepuri mbahej si trim i madh.

Një ditë prej ditësh, pa pritur dhe pa kujtuar, lepuri dhe iriqi u gjetën ballë përballë me njëri tjetrin.

Iriqi i shkretë, nga frika, i foli lepurit me nderime të mëdha:

– Ah, sa të butë që ma paske leshin, more lepur zotëri!

– Çudi! – iu përgjigj lepuri. – Kaq shpejt u binde për leshin që e kam të butë? Po, nuk e di që zemrën unë e kam edhe më të butë?

Dhe që atë ditë, iriqi filloi t’ia ndukë lepurit leshin dhe ta shpojë me gjembat e vet. Lepuri s’guxoi më ta ngacmojë.

Siç shihni, dukja e jashtme nuk vlen, por vlen zemra.

Rexhep Hoxha

NËNË, O NËNË

Fjalë e ëmbël, shumë e lartë

Është fjala nënë.

Gjuhë nënës është e artë,

Nënë, o dritë, o hënë.

Ajo është zemra e jetës,

Që lind burra dheu,

Luftëtarë të së vërtetës

Siç ish Skënderbeu.

Lule e bardhë porsi dritë

Nëna është në botë,

Ajo natën e bën ditë

T’i bëj fëmijët të fortë.

Fjala e njeriut, më e lartë,

Që ka për të thënë,

Është fjala e zemrës së artë

Nënë, o nënë, o nënë.

Vehbi Kikaj
BURBUQJA

Sa ëmbël qeshet
e vogla Buqe
i ka blerë baca
Sandale të kuqe!

Ia urojnë shoqet
e shokët e vet:
"Sa të bukura, Buqe,
i mbajtsh me shëndet!"

Ëmbël qesh Bushja
si lulja n'degë –
me sy e faqe
t'kuqe si shegë.

Fabul popullore
LUANI E MIU

Një ditë, kur bënte vapë e madhe, luani ishte shtrirë nën hijen e një lisi dhe flinte. Një mi i vogël kaloi mbi shpinën e madhe të luanit dhe filloi t'ia hante veshin. Luanit i doli gjumi dhe e kapi menjëherë miun e vogël.

– Si guxon ti, micrrak, të kalosh mbi shpinën time?! – e pyeti luani dhe u bë gati t'ia shtypte kokën me shputën e tij të madhe.

– Më fal kësaj here, të lutem. Unë gabova. Tjetër herë nuk e bëj më këtë gabim – tha miu. Luani e fali.

Pas disa ditësh luani ishte ngatërruar në rrjetën që e kishin lëshuar fshatarët për të zënë bishat e malit. Luani britte sa mundte dhe askush nuk i afrohej për t'i ndihmuar.

Kur e dëgjoi miu, të cilit luani ia kishte falur jetën, vrapoi menjëherë tek ai. Me dhëmbët e tij të mprehtë ia brejti litarët dhe e shpëtoi luanin.

– Sa gjëra të çuditshme ndodhin në këtë botë! – tha luani. Më liroi miku im i vogël.

– Çudi e madhe! Kush mund të mendonte se edhe miu mund ta shpëtojë luanin nga vdekja?!

La Fonteni
DHELPRA E KORBI

Një ditë një dhelpër e uritur pa një korb në degë. Korbi kishte në sqep një copë djathë.

Dhelpërës iu tek t'ia marrë. Po qysh? Në dru nuk mund të ngjitej. Pasi mendoi pak, shkoi nën dru dhe, duke shikuar korbin, tha:

"Mirëmëngjesi zoti korb! Sa shpend i bukur je! Më kanë thënë se edhe zërin e ke shumë të bukur. Dëshiroj të të dëgjoj duke kënduar".

Korbi i erdhi mirë për këto fjalë lavdëruese. Hapi sqepin për të kënduar, por copa e djathit i ra në tokë. Dhelpra kërceu dhe e rrëmbeu djathin menjëherë. Shkoi në pyll dhe e hëngri duke qeshur.

Jovan Jovanović-Zmaj

DIJA

Qeshu pak, moj Dije,
Hiq gishtat nga goja!
Babës e nënës një fije
Gicat ti tregoja!
Uh, sa t'bardha gicat
Kur qeshesh, na kënaqe;
Edhe dy pusat
T'i shohim në faqe.

Qamil Guranjaku

KUKULLA IME

Mblodha shkopin me një sukull
Dhe kështu e bëra kukull,
Porsi nuse bukuroshe,
Dhe e vura në një qoshe.

Me gjithë shpirt e fort e dua,
Fjalë të bukura kuvendoj;
Her'e puth e ledhatoj,
Se dhe kukulla më do mua.

Lamtumirë, o kukulla ime,
Lamtumirë, moj faqemollë,
Se m'erdh koha për mësimë,
Se m'erdh koha për në shkollë.

QUKAPIKU

Quk, quk qukapik,
Pema është në rrezik.
Qukapik, ti ku je?
Eja shpejt ndihmona ne.
Ne çdo pemë, në çdo oborr,
Edhe zog, edhe doktor.
Eja, eja mos ki frikë,
Kjo çukitje është muzikë.

Adelina Mamaqi

MOJ KËPUCË

Moj këpucë budallaqe,
pse u zgjidhe përsëri?
Nuk e sheh? M'u skuqën faqet:
të të lidh akoma s'di.
Moj këpucë, moj këpucë,
tekanjoze, nuk merr vesh?
Ç'më je futur mu në llucë,
gojë hapur më përqesh?

Po këpuca (çfarë këpuce!)
thotë: gjyshen mos e thirr
lidhmë vetë të mos skuqesh,
Si mendoni, thotë mirë?

Qamil Guranjaku

KALI I VOGËL

Pata një kalë në vegjëli,
ishte me shalë e me zingji.
Bisht e fre
të gjitha i kishte.
Hante, rrinte tok me mua,
edhe pinte ujë në krua.
Kali i drunjtë, sa të doja
pas të merrja
ngado që shkoja.

SHËNIME

SHËNIME

SHËNIME

SHËNIME

SHËNIME

SHTOJCA ME FIGURA

